



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 11

Rrogozhinë, më 26.09.2024 ora 14 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Zv. Kryetarit të Këshillit Bashkiak me Nr.3982.Prot datë 19.09.2024, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.10, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 19.07.2024.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare në lidhje me rehabilitimin e rezervuarit të Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryeviidh”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e nismës së Aleancës së Grave Këshilltare, për mbështetjen financiare të projektit ‘Një rrugëtim drejt të ardhmes’.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës së z. Xhelal Tosku për sponsorizimin e botimit të librit”.
- 9- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e fondit të akorduar për mbulimin e rritjes së nivelit të pagave”.
- 10- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të bashkisë Rrogozhinë”.
- 11- Informacion nga Drejtoria e Politikave Urbane dhe Sektorëve të saj, mbi punën e bërë për periudhën Janar-Korrik 2024.
- 12- Informacion mbi masat e marra nga Drejtoria Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe



- Vaditjes për pastrimin e kanaleve të para të dyta e të treta dhe përgatitja e tyre për dimrin.
- 13- Informacion mbi punën e bërë nga Sektori i Pyjeve dhe përmisimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.
- 14- Informacion mbi punën e bërë për përgatitjen e vitit të ri shkollor nga Drejtorja e Arsimit dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse pranë Bashkisë.
- 15- Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Gusht 2024.
- 16- Të ndryshme.
- *Shqyrtim i kërkesës së qytetarit z. Fahri Rexhepi për trajtimin dhe strehimin e qenve endacakë.*
 - *Shqyrtim i kërkesës së qytetarit z. Haziz Kashari për ndihmë financiare për rikuperimin e dëmit të kafshëve të ngordhura.*
 - *Të tjera.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Lije Dedej, Saimir Cani, Isa Halili, Sokol Gosa, Mitat Daja, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Renato Kalemi, Shpati Kolgega, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Merilin Saraçi, Besnike Coraj, Fatbardha Sina (dorëhiqet nga mandati i këshilltarit në këtë mbledhje).

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkyetar i Bashkisë.
3. Astrit Mertiri - Administrator i Njësive Administrative Kryevidh
4. Deshir Gjumsi - Administrator i Njësive Administrative Lekaj
5. Denis Sako - Administrator i Njësive Administrative Gosë
6. Mexhit Saliu - Administrator i Njësive Administrative Sinaballaj
7. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
8. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
9. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
10. Ledian Hasani - Drejtor i mirëqënies dhe kujdesit social.



11. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
12. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
13. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
14. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
15. Artur Kaja - Përgjegjës i sektorit të pyjeve.
16. Dorina Shehi - Përgjegjëse e Kadastrës.
17. Ismail Broli - Përgjegjës i Lejeve Zhvillimore
18. Sami Veliu - Përgjegjës i sektorit të projektimit dhe menaxhimit të kontratave.
19. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

Drejtton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 16- Këshilltarë (z. H. Xhani dhe z. I. Halili i bashkohen mbledhjes në vijim).

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përsëritet të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : Silvana Aliu, Indrit Dedej, Lije Dedej, Saimir Cani, Sokol Gosa, Mitat Daja, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Renato Kalemi, Shpati Kolgega, Erind Tosku, Mukades Gixhari. Gjithsej 16- Këshilltarë.

Mbledhjen e datës 19.07.2024 janë miratuar dy vendime nga Këshilli Bashkiak të cilët janë : Vendim nr .37, datë 19.07.2024 “Për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”.

Vendim nr .38, datë 19.07.2024 “Për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Këto vendime hyjnë në fuqi sipas pikës, 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar.

Para se të kalojmë në rendin e ditës ja japim fjalën z. Indrit Dedej pasi ka diçka për të na komunikuar.



-Për shkak të një problemi në audio, më poshtë paraqitet e përmbledhur fjala e këshilltarit z. Indrit Dedej.

Indrit Dedej . Po ju paraqes dy deklarata, të cilat i keni dhe me shkrim dhe të nënshkuara. E para grupi i këshilltarëve të opozitës në mledhjen e fundit të tij vendosën unanimitisht shkarkimin e z. Hekuran Xhani si nënkryetar i Këshillit dhe emërimin e z. Saimir Cani në këtë pozicion nënshkuar nga 5 këshilltarë të opozitës. E dyta, jap dorëheqjen si kryetar i grupit të djathtë për shkak se këshilltarë të caktuar kanë dalë jashtë linjës së kordinuar të këshilltarëve të opozitës.

-Kthehet audio pas 4 min të zhvillimit të mbledhjes.

Ervis Shera . Për shkarkimin e nënkryetarit duhen 7 firma për propozim dhe 11 vota për shkarkim.

Shpati Kolgega . Pra duhen 11 firma për ta shkarkuar dhe 7 firma ...?

Ervis Shera . Për ta propozuar.

Silvana Aliu . Kur e propozuam ishim vetëm 4 këshilltarë atëherë pse kërkon 7 firma tani?

Ervis Shera . Ju si opozitë sollët propozimin.

Silvana Aliu . Po pra 4.

Indrit Dedej . E mbani po doni ...

Silvana Aliu . Ç'lidhje ke me pjesën tonë, ne do vejmë atë që duam ne.

Enver Memolla . Hidhe në votim.

Lulzim Hasa . Çfarë të keqe ka ta votojmë ta shkarkojmë s'ka ndonjë të keqe.

Renato Kalemi . Të ketë bazë ligjore.

Mitat Daja . Bëhet shkarkimi dhe emërimi.



Lulzim Hasa . Të hidhet në votim këto duan ta shkarkojnë e shkarkojnë, duan tjetrin emërojmë tjetrin.

Enver Memolla . Propozimi është i juaji ai do hidhet në votim.

Mukades Gixhari . Deri sa të gjejë Visi atë (bazën ligjore) vazhdojmë me rendin e ditës. Keni te fotokopjuar para secili projektvendimin “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

- Miratohet me 16-vota pro, përfshirja në rend dite e projektvendimit , “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në rendin e ditës. Miratim i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

- Miratohet me 16-vota pro, pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 2, Miratim i procesverbalit Nr.10, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 19.07.2024. Jeni dakord me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar? Të gjithë pro. Miratohet.

- Miratohet me 17-vota pro, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Pika 3, Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i Mbrojtjes dhe Kujdesit Social z. Ledian Hasani. Përhëndetje fjala për ju.

-Mbledhjes i bashkohet z. Hekuran Xhani në minutën e 8 (tetë) të zhvillimit të mbledhjes.

Ledian Hasani . Kemi 18-familje me një fond rreth 80 mijë lekë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike për 6%? E hedhim në votim . Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 17-vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.



Vendim nr.39. Miratohet me 17-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3281.Prot datë 01.08.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3281/1.Prot datë 01.08.2024.

Mukades Gixhari . kalojmë në pikën 4, Miratim i projektvendimit , “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.

Ledian Hasani . Gjithsej janë 18 familje dhe fondi është rreth 84 mijë lekë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? E hedhim në votim. Vota pro, kundër, abstenim. Miratohet.

-Miratohet me 17-vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr.40. Miratohet me 17-vota pro, projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.3282.Prot datë 01.08.2024, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i pushtetit vendor” si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3282/1.Prot datë 01.08.2024.

Mukades Gixhari . Shkojmë tek projektvendimi që përfshimë në rend dite , “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”. Këtë që sapo e pranuar. Ndonjë pyetje? Pro kundër abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 17-vota pro, projektvendimi , “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”.

Vendim nr .41. Miratohet me 17-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4025.Prot datë 24.09.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4025/1.Prot datë 24.05.2024.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 6-të... Vazhdojmë rikthehemi tek 5, Miratim i projektvendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Ndonjë pyetje rreth kësaj?

Ledian Hasani . Janë 17 familje dhe fondi është 76 mijë lekë të reja.



Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Miratohet.

-Miratohet me 17-vota, pro pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr .42. Miratohet me 17-vota pro, projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.3834.Prot datë 11.09.2024, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.3834/1.Prot datë 11.09.2024.

Mukades Gixhari . Tani kalojmë tek pika 6-të, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare në lidhje me rehabilitimin e rezervuarit të Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevidh”. Relaton përfaqësuesi i Kryevidhit z. Shkëlqim Gjoni. Përshëndetje z. Shkëlqim.

Silvana Aliu . Përfaqësues jo administrator.

Shkelqim Gjoni . Rezervuari në vetvete është përbahet nga baseni dhe nga diga , Baseni është pjesa që e mban ujin dhe diga është pjesa që e pret ujin. Ato që janë marrë në kooperativë pak a shumë i dinë strukturat e rezervuareve, në digë montohen 2 shkarkues , pusi fundor dhe shkarkuesi emergjent. Vetë nga emri shkarkuesi fundor është shkarkues i cili komandon ujin , ul nivelin për ta përdorur për vaditje për ta dërguar në mënyrë të ekuilibruar nëpër tokat e banorëve të zonës. Ndërsa shkarkuesi i emergjencën nga vetë emri futet në punë në raste emergjente në raste të rralla kur rezervuarit i është bllokuar pusi fundor pra tubacioni që merr ujë nga fundi i rezervuarit dhe e shkarkon. Nga viti në vit niveli i ujit është ngritur e kam thënë dhe herë të tjera kushtet e kohës bien shira , diga është e mbuluar me pemë dhe me shkurre . Edhe shkarkuesi i emergjencës i cili përdoret dhe hyn në punë vetëm në raste emergjente dhe ky është mbuluar nga bimësia dhe ka dhe rrëshkitje në të gjithë pjesët e tij dhe ka nevojë për riparim. Me një fjalë problematika kryesore është shkarkuesi fundor i cili komandon të gjithë ujin. Në këto kushte riparimi është i nevojshëm për ta mbyllur këtë problematikë. Ne kemi kërkuar këtë se të gjithë rezervuaret kanë nevojë për riparim sepse duhet të jemi koshient pak nuk ka specialistë edhe pak bashkia dhe komuna nuk ka adresuar kërkesat dhe normal që çdo vepër vjen duke u rrëzuar. Unë mendoj, së bashku me përfaqësuesit e prefekturës bëme një studim dhe mendojmë që kjo ka nevojë për ndërhyrje. Nëse duhet akoma më shumë...

Elton Xhani . Tani gjatë inspektimit që është bërë nga Prefektura ka qenë dhe ish administratori atje problemi më i madh janë këto që tha Çimi por ka edhe humbje. Duke qenë se ka humbje mendohet që ka filtrim , nëse ka filtrim diga pastaj është situatë shumë emergjente.



Erind Tosku . Tani diga ka bllokim në pjesën fundore nga se ka ardhur ky bllokim çfarë nënkupton se mund të bëhet zhblokimi diçka me mjetet e bashkisë. Sa irëndësishëm është ky rezervuar për banorët e Domenit?

Shkelqim Gjoni . Rezervuari në fundi e tij ka shkarkuesit fundor , ky përdoret për manovrimin e ujërave në rezervuar. Tani pse është bllokuar?- Tani nga gërryerjet gjithmonë rezervuaret nga erozioni nga ledhi që vjen ndër vite e ka bllokuar këtë pjesë dhe ndër vite këto nuk janë riparuar. Mbase nuk ka teknikë, mbase nuk është ndërhyrë dhe është ngritur niveli fundor i saj është mbuluar me ledh dhe nuk e kryen funksionin .

Erind Tosku . Sa i rëndësishëm është për banorët a kemi interes të bëjmë rehabilitimin?

Shkelqim Gjoni . Është sepse nën digë ndodhet fshati Kazie lagjja e re, në rast përmbytje këtu i rrizkohet jeta baorëve. Edyta në periudhën e verës vadit e gjithë fusha e pjesës së Kazies në fushë jo në kodër .

Erind Tosku . Është funksional përdoret për vaditje?

Shkelqim Gjoni . Po përdoret për vaditje.

Erind Tosku . Me rehabilitimin kthehet në funksion të plotë vaditje për sezonin e verës.

Enver Memolla . znj. Kryetare unë fillimisht doja të ndërhyja për porcedurë për këtë projektvendim dhe fillimisht do doja të ndalojë kakofonia e mbledhjes. Unë e di Çimi është mik i joni është ish administratori por nuk është personi përgjegjës për të na dhënë shpjegim ta nisim njëherë nga A-ja pastaj tek Zh-ja. Kur ka qenë problematika ka qenë administrator por realisht kjo është një pikë që ... është një pikë që fillimisht para këshillit duhet të raportojnë personat përgjegjës që kanë firmosur projektvendimin. Çimi të vijë dhe të japë informacion shtesë sepse nuk është person përgjegjës për momentin për t'i dhënë këshillit bashkiak informacion . Dy personat përgjegjës janë këtu pastaj thërrasim me radhë të tjerët , kjo është procedurë për mbarëvajtjen e mbledhjes.

Indrit Dedej . Ke qenë 4 mandate 5 mandate ti je person përgjegjës që nuk e ke rehabilituar këtë rezervuar nuk është fare në kompetencën tënde. Është kompetencë e këtij këtu (Këshilltari tregon shkresën e AKMC-së).

Mukades Gixhari . Flasim të na relatojë drejtoresha juridike Enkela Ballabani, kemi dhe drejtorin e bujqësisë z. Elton Xhani.



Mitat Daja . Të bëj unë një pyetje se kjo puna e rezervuarit është bërë si legjendë në fakt e kam dëgjuar 2- herë nuk kam marrë pjesë . Këtë lloj investimi ne po kërkojmë ta bëjë Bashkia apo dikush tjetër do e bëjë këtë investim?

Edison Memolla . Agjensia Kombëtare për Mbrojtjen Civile nuk e bën Bashkia .

Mitat Daja . Çfarë roli ka Bashkia vetëm paraqet një kërkesë?

Edison Memolla . Çohet një kërkesë dhe nëse miratohet është përfituese.

Mitat Daja . Pikërisht thjeshtë do përfitojmë fonde nga një Institucion tjetër. Pra Bashkia është zero investim vetëm përfitim?

Edison Memolla . Vetëm përfitim.

Mitat Daja . Atëherë unë nuk e di pse diskutohet, tani ky është mendimi im se nuk është e thënë të jemi në një mendje. Pse duhet ta diskutojmë kaq shumë një kërkesë që do i lutemi dikujt tjetër për të na dhënë fonde, për të bërë diçka të mirë. E para punës atje sikur vetëm rezervuari të bëhet do i shkojë mendja dikujt do bëjë një agroturizëm. U bë legjendë kaq e madhe fundja fundja cila është përgjegjësia ndoshta ajo drejtoresha juridike mund të na thotë. Cila është përgjegjësia e Këshillit Bashkiak në këtë rast nëse e supozojmë marrim shembullin më të keq ka një abuzim, kemi përgjegjësi ne që bëjmë një kërkesë? A kemi ne përgjegjësi që bëjmë një kërkesë që themi duam të rregullojmë këtë?

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë drejtoreshën juridike.

Mitat Daja . Ta mbaroj pyetjen, se ne nuk jemi as inxhiniera ,as njerëz që bëjnë preventiva që ta dijme sa është shuma e preventivit. Ne thjeshtë jemi njerëz që kërkojmë diçka, Bashkia shumë mirë ka paraqitur duke u bazuar tek administratori dhe vende tjera që është bazuar. Dmth kemi ne përgjegjësi nëse ne aprovojmë këtë kërkesën, supozojmë.

Enkela Ballabani . Në këshill kërkohet vetëm të miratojë fondin i cili supozohet që do vijë nga AKMC dhe do shkojë vetëm për pjesën e digës. Administrimi i fondeve nuk është përgjegjësi e këshillit nuk përmban asnjë përgjegjësi ligjore përse i përket ...

Mitat Daja . E dija por për të ma konfirmuar.



Enkela Ballabani . Derisa administrohet nga Bashkia.

Mitat Daja . Pra thjeshtë ne po bëjmë një kërkesë dhe shpresojmë të na i japin këto fonde.

Enkela Ballabani . Pikërisht sipas vendimit nr.53 të vitit 2023 këshilli në nenin 7 të pikës 2 kërkon Vendimin e Këshillit Bashkiak për të përcaktuar destinacionin e përdorimit të fondit të kërkuar për emergjencën civile. Ju keni vetëm të votoni që fondi do të shkojë ...

Mitat Daja . E kuptova. Pyetja tjetër është ose për financën ose për kryetarin e bashkisë. Bashkia do investojë diçka në këtë projekt? Marrim një shembull.

Edison Memolla . Jo bashkia nuk investon asgjë.

Mitat Daja . Bashkia nuk investon. Nuk kam çfarë them më.

Silvana Aliu . Unë nuk kuptoj diçka kur paska qenë kaq e thjeshtë Prefekti pse e ktheu mbrapsht?

Enkela Ballabani . Herën e parë Prefekti e ktheu se në këshill erdhi si emergjencë civile dmth nuk e vendo këshilli emergjencën civile. Duke qenë se projektvendimi nga ana jonë ishte bërë gabim prefektura e ktheu mbrapsht. Këtë herë e kemi bërë sipas kërkesave të ligjit dhe sipas vendimit nr.53.

Lulzim Hasa . Zonja kryetare si banor dhe si këshilltar i asaj zone, jam i detyruar të jap disa shpjegime që kolegët e mi të jenë më të qartë për këtë projekt . Ky rezervuar është ndërtuar bë vitet 80 për t'i shërbyer asaj kohe tokave që zbresin nga Kaziet në bregdet që janë 200 rreth metra nga bregu i detit. Me ndryshimet politike që ndodhën ky fshati Kazie mungon e gjithë infrastruktura me lëvizjet demografike dhe me ndarjen e tokave me ligjin nr.7501, rreth 30 % e kytëre familjeve le të themi që ai fshat ka qenë rreth 100 familje se unë e njoh mirë kam punuar në atë zonë, iku në qytet kryesisht në zonën e plazhit në Durrës. Janë mbi 100 ndërtesa, banesa, biznese dhe objekte tani ky rezervuar që u ndërtua ky është i amortizuar komplet diga ka pësuar çarje dhe krisje dhe qëllimi kryesor tani nuk është vaditja e zonës por është ruajtja e jetës e bizneseve dhe e pronës së tyre qytetarëve të zonës. Unë nuk e di çfarë ju shqetëson ne jemi të mandatuar dhe të zgjedhur nga populli i asaj zone dhe impakti jonë në miratimin e vendimeve ka pozitiv dhe negativ në komunitet, pse mos i vijmë në ndihmë këtyre qytarëve çfarë ka, fondin na e japin të tjerët punën do e bëjnë të tjerët. Ku këto banorë e bëjnë jetën me ëndrra për jetën e fëmijëve të tyre . E çfarë përfitojmë ne se u përmyt ai fshat të tjerët duan ta bëjnë dhe ne nuk



duam “I zoti e jep tellalli se jep”, është e disata herë që diskutojmë. Unë propozoj të ngrihet një grup pune të shkoi të shohi në vend në qoftë se nuk qëndrojnë këto fjalë që them unë , unë jap dorëheqjen nga mandati i këshilltarit. E lagu se lagu ne nuk nxjerrim gjë fond nga xhepi, Bashkia nuk nxjerr gjë ai fond ka një drejtim të caktuar është grant i kushtëzuar ose shkon këtu ose nuk shkon fare. Ç farë përfitimi kemi ne ta kthejmë mbrapsht? Prandaj i ftoj këshilltarët të tregohemi në nivelin e duhur t’i vijmë në ndihmë atyre banorëve.

Indrit Dedej . Kam shumë paqartësi si për nga ana juridike ajo që është nuk merr vesh fort...

Edison Memolla . Nuk ke pse ofendon punonjësit e bashkisë thuaj çfarë ke më thënë.

Indrit Dedej . Nuk po e ofendoj është e re.

Edison Memolla . Nuk do të thotë se është e re e smerr vesh mund të dijë më shumë se një i vjetër.

Indrit Dedej . A ka punonjës bashkie që paguan bashkia në ruajtjen e rezervuarit?

Edison Memolla . Jo nuk ka.

Indrit Dedej . Pse nuk ka?

Edison Memolla . Do një buxhet.

Indrit Dedej . Megjithatë ai aty këshilltari nuk është administrator ...

Lulzim Hasa . Jam mbi administratorin unë.

Indrit Dedej . Nuk jam kundra investimeve, ju nuk sollët një skrep.

Edison Memolla . Ka ardhur skrepi .

Enver Memolla . Ajo që fola pak më parë jo se kisha diçka me Çimin, po thjeshtë personat përgjegjës të flasin për të mbrojtur projektvendimin e tyre. Meqë ky investim është kaq i madh realisht Luli banon atje edhe Çimi, unë doja të dija përveç digës baseni është mbushur? Se nga kuota që më thanë a ka nevojë për pjesë investimi që dhe të pastrohet, se siç thotë dhe Luli që aty shfrytëzohet për vaditje për pjesën e bregdetit, normalisht duhet të jetë...



Edison Memolla . Do shkohet deri në vend.

Enver Memolla . E kam fjalën meqë po bëhet gjithë ky investim të bëhet nga A-ja tek ZH-ja për të mirën e të gjithëve.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër rreth kësaj? Ta hedhim në votim pikën 6-të. Vota pro, kundër, abstenim? Atëherë t'i numërojmë, 13 (trembëdhjetë) pro, 4 (katër) kundër, 0 (zero) abstenim. Miratohet.

-Miratohet me 13 (trembëdhjetë) pro, 4 (katër) kundër, 0 (zero) abstenim pika 6-të e rendit të ditës.

Vendim nr.43. Miratohet me 13-vota pro, 4-vota kundër projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3971.Prot datë 19.09.2024 “Për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare në lidhje me Rehabilitimin e Rezervuarit të Domen fshati Domen, Njësia Administrative Kryeviidh”, si dhe Relacioni shpjegues me Nr.3971/1.Prot datë 19.09.2024.

Mukades Gixhari . Fjala për z. Hekuran Xhani.

Hekuran Xhani . Të nderuar Këshilltarë, e nderuar Kryetare, i nderuar Kryetar!

Ky vendim që ne sapo morëm, u bë pengesë edhe për rrjedhën normale të Këshillit Bashkiak . Shqipëria vetëm në muajin Gusht bëhet 50 %, siç e ka krijuar Zoti nuk bëhet m. Unë me votën time kam votuar gjithmonë dhe do të votoj gjithmonë jashtë presionit politik, jashtë dallave të politikës çdo vendim që i shërben qytetarëve të mi që mua më kanë dhënë votën dhe më kanë sjellë në këtë këshill, për të përfaqësuar ata denjësisht jashtë luftës së pandershme politike që bëhet në këtë këshill dhe pothuaj u bë si modë në gjithë Shqipërisë. Tani unë nuk e di sa pengesë i doli atij të ndihmës ekonomike moszhvillimi i mbledhjes së muajit Gusht. Të nderuar këshilltarë më mirë të kishim ndenjur 6-të muaj pa bërë mbledhje këshilli atë muaj që kishim fëmijët dhe vëllezërit tanë duhet të ishim këtu. Sepse unë vi nga një fshat atje që kur u kthyen djemtë e familjeve tona në familje filluan me blerë ujë për t'u larë jo për të pirë dhe pikërisht prandaj isha këtu. Plehrat erdha dhe me foto atë ditë, si asnjëherë tjetër ato ditë që ato vihen edhe një pjesë thotë që erdhëm kot ç'na u desh që erdhëm. Prandaj shoqërore unë them që në muajin Gusht ne si të zgjedhur duhet të rrijmë pranë qytetarëve edhe në krye të detyrës. Faleminderit.

Indrit Dedej mos të vijë kur ta thërrasi partia por të vijë kur ta thërrasi populli. Edyta edhe t'i bërë shumë gabim që ja dhe fjalën atë ditë sepse nuk u zhvillua mbledhja e këshillit bashkiak. S'mund të ja japësh fjalën në një mbledhje këshilli që nuk zhvillohet.



Hekuran Xhani . Tani në mbledhjen që nuk ka kuorum nuk merret vendim zotëri, nuk mund të më mohosh ti drejtën... dëgjo Indrit shumë superxhiro edhe po merr shumë, tani je aty në krye të atij grupi në emër të Partisë Demokratike kaq po të them. Duket sikur nuk e di çfarë pozicioni, çfarë përgjegjësie ke...

Indrit Dedej . Ta shpjegoj unë çfarë pozicioni dhe përgjegjësie kam...

Hekuran Xhani . Kaq po të thotë Hekri se po të analizoj, këtë e zgjidhim në grupin tonë politik jo këtu. Unë ju ftoj të merrni pjesë në muajin Gusht thashë sepse një herë bëhet Shqipëria gjysëm.

Indrit Dedej . Në radhë të parë jam kryetar grupi i opozitës në radhë të dytë jam kryetari ti nuk pate parti fare.

Hekuran Xhani . Mirë në rregull, e sqarojmë do mbledhim grupin.

Indrit Dedej . E kam mbledhur.

Hekuran Xhani . Ti s'ke mbledhur grupin pa më thirrur mua.

Indrit Dedej . Të kam çuar mesazhin.

Hekuran Xhani . Kur e ke çuar mesazhin? E nderuar kryetare kjo është pjesë e jashtë...

Indrit Dedej . Bëj dorëheqje dhe shko ku të duash.

Hekuran Xhani . Të bëj unë dorëheqje... ti do më përzeshe nga partia mua?!

Indrit Dedej . Jam kryetar grupi.

Hekuran Xhani . Çfarë kryetar grupi, lëre tashi se ta tregoj unë kryetarin e grupit ty, ty dhe dallaveraxhijve të tjerë mbrapa.

Indrit Dedej . Unë si kryetar grupi e kam shkarkuar.

Hekuran Xhani . Mirë, mirë nuk merr vendime ti i merr partia.



Indrit Dedej . Ty ishalla të mbron Edisoni me ...

Silvana Aliu . E partisë jam edhe unë ...

Hekuran Xhani . Pse kur nuk kam diskutuar me grupin, iki vetë nuk kam nevojë.

Mukades Gixhari . Do vazhdojmë mbledhjen. U lidhët me Fatbardhën ? Kemi një komunikim online të kërkur nga anëtarja e këshillit Bashkiak znj. Fatbardha Sina e cila ndodhet jashtë Shqipërie. Ju lutem ta dëgjojmë. Përshëndetje znj. Fatbardha!

Fatbardha Sina . Përshëndetje të gjithëve si jeni? Siç edhe jeni në dijeni, për arsye personale kam vendosur që të jap dorëheqjen nga mandati i këshilltares së këshillit bashkiak.

Mukades Gixhari . Në rregull Fatbardha faleminderit për kontributin e dhënë deri më tani në Këshillin të Bashkiak Rrogozhinë dhe të urojmë suksese në jetën tuaj.

-Këshilltarët njëzëri i urojnë suksese znj. Fatbardha Sina.

Mukades Gixhari . Kam raportin e komisionit të mandateve që propozon pranimin e dorëheqjes nga mandati i anëtarit të këshillit bashkiak znj. Fatbardha Sina. E hedhim në votim dorëheqjen e znj. Fatbardh. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro, 0- kundër, 0-abstenim, propozimi i komisionit të mandateve për pranimin e dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të znj. Fatbardha Sina.

Vendim nr.44. Miratohet me 17-vota pro, pranimi i dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të znj. Fatbardha Sina mbështetur dhe në kërkesën me Nr.4062 .Prot datë 26.09.2024 për dorëheqjen nga mandati i Këshilltarit të znj. Fatbardha Sina, referuar dhe deklarimit për dorëheqje të bërë në lidhje online në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak.

Mukades Gixhari . Gjithë të mirat Fatbardha!

Fatbardha Sina . Faleminderit shumë të gjithëve.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 7, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e nismës së Aleancës së Grave Këshilltare, për mbështetjen financiare të projektit, ‘Një rrugëtim drejt të ardhmes’ “. Kemi drejtorin e financës z. Rezart Vogli dhe znj. Alime Hoxha në qoftë se do që ta marrë fjalën.



Rezart Vogli . Kemi marrë një propozim nga aleanca e grave Këshilltare, të Këshillit tonë bashkiak.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje, ndonjë diskutim rreth kësaj...? Po znj. Alime.

Alime Hoxha . Unë jam anëtare e aleancës drejtohuni ... Në fakt ishte një iniciativë për mbështetjen e nxënësve që ndjekin shkollën e mesme. Duke menduar që duke parë dhe situatën që shkollat tona numri vjen duke u ulur një pjesë e nxënësve ndjekin arsimin e mesëm në Kavajë. Tani ne nuk e mbështesim dot me ligj gjithë... nuk e mbulojmë dot transportin por duke ju ardhur në ndihmë këtyre familjeve mendojmë që të ju financojmë pjesërisht transportin dhe ato të vijnë ta ndjekin gjimnazin në Rrogozhinë apo në Gosë. Ishte një nismë për t'i ardhur në ndihmë familjeve në nevojë për t'i mundësuar ndjekjen e arsimit të mesëm. Nga përlllogaritjet që kemi bërë na del një, duke parë dhe numrin kemi marrë informacion në çdo shkollë , largësinë na del një fond prej 892 000 (tetëqind e nëntë dhjetë e dy mijë) lekësh të reja për një vit shkollë, tani është në dorën e këshillit.

Mitat Daja . Kisha unë diçka këtu.

Indrit Dedej . Ne u dakordësuar në komisionin e ekonomisë bashkë me drejtoreshën .

Mukades Gixhari . Jeni dakordësuar? Po, z. Mitat.

Mitat Daja . Pse nuk është paraqitur një listë emrash këtu kush përfiton . Tani është bërë një kërkesë e përgjithshme dhe normalisht drejtorët e shkollave kanë evidentuar njerëzit që janë në nevojë s'është paraqitur ndonjë listë emrash. Mund të vi dhe unë të them xhamia Rrogozhinë ka nevojë për 10 milion lekë .

Alime Hoxha . Nuk është miratuar asnjë listë. Ne po kërkojmë një fond të cilin do ta shfrytëzojmë për këtë mënyrë për momentin fondi nuk është miratuar dhe ky fond do hynte në miratim ...

Mitat Daja . A po kërkon të miratohet.

Alime Hoxha . Po, po kërkoj të miratohet një fond për ta patur një fond të cilin ta shfrytëzoj për këtë, për nxënësit që do vijnë do verifikohen ...

Mitat Daja . Do verifikohen nuk është bërë asnjë lloj verifikimi .



Rezart Vogli . Po flasim për një fond i cili është miratuar në buxhetin e vitit 2024...

Mitat Daja . Ju keni miratuar shumë gjëra në buxhet dhe jo të gjitha janë bërë.

Rezart Vogli . Dhe po kërkohet fondi për këtë arsye.

Mitat Daja . Tani pse nuk është paraqitur kjo kërkesë me një listë emrash personash përfitues dhe pastaj ta shohim dhe ta miratojmë nuk po kërkoj ndonjë gjë të veçantë nëse jam gabim thoni jam gabim.

Silvana Aliu . T'i bëjmë hapat një nga një vendosëm që të miratohet dhe pastaj së bashku do të hartojmë një listë .

Mitat Daja . Të ishte lista jam shumë dakord është bërë shumë mirë, por pa listë unë mendoj që nuk duhet të kalojë ju bëni çfarë të doni unë një votë kam.

Erind Tosku . Edhe unë jam pjesë e kësaj nisme ...

Mitat Daja . Këtë e bën aleanca e grave ç'punë ke ti me nismën?

Erind Tosku . Mos u emociononi ti, kur përmenden gra në relacion ti përmendesh i pari... hoxha ku ka gra flet.

Mitat Daja . Kujdes.

Erind Tosku . Unë po thoj që normalisht duhet një iniciativë e tillë që nxënësit të kenë mundësi të afrohen në universitetin e qytetit tonë që është gjimnazi jonë. Normalisht që duhen nisma të tilla kjo pjesa se nuk bëhet pa nismë kjo gjë edhe nuk mund të kemi listë emërore në qoftë se nuk vijnë nxënës.

Mitat Daja . O vlla shkolla ka filluar, ka një muaj shkolla që ka filluar...

Erind Tosku . Bëhet nisma...

Mitat Daja . Shoqëroje me emra.

Edison Memolla . Më fal krijohet një nismë në bazë të kësaj nisme do shpalejt të gjithë nxënësit do paraqesin kërkesën.



Enver Memolla . Mos i ngatërrojmë gjërat në Këshill po na kërkohet miratimi i kësaj nisme. Në mbledhjen e komisionit të ekonomisë edhe vetë drejtori i financës tha që po këtë fond bashkia ka mundësi ta mbulojë dhe nga fondet e veta miratuar në buxhetin e kaluar. Tani çfarë duhet ky debat, ne kemi pikën të kalojmë këtë fond, ka bashkia fonde për këtë pjesë?- Ka. Ku është problemi këtu?

Mitat Daja . Problemi është kjo nismë që është përcaktuar 9 milionë apo ku e di unë duhet të ketë emër dhe mbiemër ku do i çoni këto lekë?

Enver Memolla . Po ta jap unë përgjigjen në projektvendim e ke për secilin nxënës dhe për secilën rrugë.

Mitat Daja . Ke vendosur kritere këtu ti zotëri?

Enver Memolla . Ka vendosur Bashkia.

Mitat Daja . Të na i paraqesi drejtori i financës kriteret, dua dhe unë kam dhe unë ca miqtë e mi.

Silvana Aliu . Atëherë për t'i kthyer një përgjigje anëtarit të këshillit , kjo ndihmon të dyja shkollat ti e di shumë mirë se je mësues ndihmon nxënësit por paralel edhe mësuesit shkurt. Nëse ke emra për të futur na i sill i marrim parasysht dhe kaq.

Mitat Daja . Mos u keqkuptoni nuk kam kundërshtim fare...

Shpati Kolgega . Hajde ta hedhim në votim kush është kundra ta votojë kundra...

Mitat Daja . Në votim e hedhim por na lër të flasim.

Alime Hoxha . Duke qenë se po thuhet që ka shkolla një muaj që ka filluar po është e vërtetë, kjo nismë ishte për t'u bërë që në muajin Gusht për shkak se nuk u mbledh Këshilli Bashkiak dhe kjo nismë të kishte kaluar që në muajin Gusht që ne të kishim arritur t'i kishim marrë ata nxënës sespe për këtë arsye ato nxënës nuk na kanë ardhur këtë vit shkollor nuk ju mbulua nuk ju premtua që kjo do ishte ...

Mitat Daja . Dmth ky fond do u digjka për këtë vit ...?



Alime Hoxha . Të lutem tani ta mbaroj unë pastaj fol. Pra në momentin që kjo nismë nuk u arrit të kalohej në këshill ne nuk arritëm dot t'i merrnim ato nxënës të gjithë sa prisnim do shikojmë listat në secilën shkollë në gjimnazin e Rrogozhinës dhe në gjimnazin e Gosës sa nga këta nxënës na kanë ardhur që ja kemi premtuar që do ju mbulojë këtë pjesë bashkia. Dhe pastaj pjesën tjetër do ta lejmë ndoshta në vitin tjetër si na shkon..

Sokol Gosa . Nisma është shumë shumë e mirë është për t'u përkrahur e tha dhe Alimeja vetë jo në Gusht por të ishte bërë Alime që në Qershor apo në Korrik...

Alime Hoxha . Po, por nuk na u arrit projektvendimi.

Sokol Gosa . Të dëgjova, prandaj i vuajmë këto pasoja deri sot... Të ishte bërë që në Maj, Qershor ky lloj planifikimi dhe do kishim një fluks të ardhur dhe nga Gërmenji apo dhe fshatrat e tjerë të na vijnë në gjimnazin tonë apo në Gosë. Jemi të gjithë dakord që kjo të miratohet nuk ka asnjë lloj kundërshtimi, tani të bëhet planifikimet llogaritë jo nga ato që na kanë ardhur sot në gjimnaz ato ndoshta i paguajmë vitin tjetër por me çfarë pretendojmë të marrim nga klasat e 9-ta në vijim, kaq e kalojmë.

Mukades Gixhari . Faleminderit, e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) -vota pro, 0-vota kundër, 1 votë abstenim (konsiderohet vota e z. Mitat Daja).

Vendim nr.45. Miratohet me 15-vota pro, 0-vota kundër, 1-votë abstenim, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3330.Prot datë 05.08.2024 “Për miratimin e nismës së Aleancës së Grave Këshilltare, për mbështetjen financiare të projektit “Një rrugëtim drejt të ardhmes”.

Mitat Daja . O zysh prit. Të çohemi ne tjerët meqë jeni shumicë të çohem unë të iki? Po ju bezdisa iki.

Shpati Kolgega . Po ta dhamë fjalën tani, se shkon pafundësisht...

Lulzim Hasa . Unë jam shumë dakord është një nismë e duhur , por duket metodologjia e përdorur nuk është e saktë ne themi 15 nxënës del kjo shumë. Po në rast se do jenë më shumë nxënës, duhet planifikim mund të dalin 17, ti i jep paradhënie pastaj?



Alime Hoxha . Ne i kishim marrë të dhënat sa nxënës...

Lulzim Hasa . Po këtë po thotë ai në qoftë se kjo rregullon 15,...15 por mund të dali 17 .

Mitat Daja . Të shkojë kërkesa për 20 milion jo për 9 milion.

Mukades Gixhari . Atëherë z. Mitat besoj se je i qartë.

Mitat Daja . Atëherë ta qartësoj pak mendimin tim se ndoshta jeni keqkuptuar. Jam shumë dakord me këtë shumë mirë bëjnë që e pranojnë këtë nismë por kjo nismë duhet të shoqërohet me procedurë ato që do ndjekin, kriteret që janë vendosur dhe listën e personave. Pse?- Siç e tha dhe Luli që e qartësojë më tepër si ide se ju nuk më latë të shkoja deri në fund e keni hallin tek votimi. Sepse ti ke kërkuar 9 milion po u deshën pak më tepër çfarë do bësh ti? E dyta shkolla ka kaluar, për çfarë duhen këto 9 milionë për vitin tjetër?

Lulzim Hasa . Jo këtu mund të jepet ky, jepet lekë...për listën ke të drejtë. Unë kam një propozim para se ta hedhësh në votim. Hidhe në votim propozimin tim është shumë e thjeshtë.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim.

Mitat Daja . Kë do hedhësh në votim o zysh?

Mukades Gixhari . Të lutem merr parasysh fjalën e z. Shpati Kolgega është një diçka për t'u duartrokatur.

Mitat Daja . Kam një propozim dhe unë ta bëj dhe unë propozimin tim. Atëherë kam një propozim kjo lloj nisme të shoqërohet me listë emrash dhe kriteret që kanë vendosur për përfituesit, le të shkojë më shumë se sa është jam shumë dakord. Jeni dakord me propozimin, thoni jo?

Mukades Gixhari . Në rregull jeni dakord ta hedhim në votim?

Mitat Daja . Në rregull propozimin tim po. Kë po hedh në votim ta kuptoj?

Renato Kalemi . Votimi u mbyll.

Erind Tosku . Zonja Kryetare më fal që po ndërhyj, jemi 14 këshilltarë po, këshilltari i pavarur



po na sjell ... u hodh në votim u miratua mbaroi. Pra kemi çështje më të rëndësishme për të diskutuar kjo u miratua.

Mitat Daja . Sa çështje ke për të diskutuar?

Erind Tosku . Shiko rendin e ditës.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 8-të, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës së z. Xhelal Tosku për sponsorizimin e botimit të librit”. Drejtori i financës z.Rezart Vogli. Fjala për ju z. Rezart.

Rezart Vogli . Shkrimtari i qytetit z. Xhelal Tosku i është drejtuar bashkisë Rrogozhinë dhe këshillit bashkiak për botimin e një libri... kostoja është 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, sipas faturës së shtypshkronjës. Mbledhjen e parafundit këshilltarët u shprehën dakord .

Mitat Daja . Sa është shuma?

Rezart Vogli . 85000 lekë.

Mukades Gixhari . 150 kopje dhe 850 mijë lekë të vjetra. Jeni dakord ta hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, pika 8-të e rendit të ditës.

Vendim nr.46. Miratohet me 16-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3329.Prot datë 05.08.2024 “Për miratimin e kërkesës së z. Xhelal Tosku, për sponsorizimin e botimit të librit”.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 9, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e fondit të akorduar për mbulimin e rritjes së nivelit të pagave”. Vazhdojmë po me drejtorin e financës z. Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Qeveria Shqiptare ka miratuar një skemë për rritjen e pagave për pushtetin vendor. Bashkia Rrogozhinë mori masat dhe para se të akordohej fond në Këshill të Ministrave kishte sjellë projektvendimin në Këshill Bashkiak. Ministria e Financës e pa të udhës që të mbështesi bashkinë me vendimin për shtesë fondesh për Bashkinë Rrogozhinë u akordua 9 272 048 lekë për mbështetjen e rritjes së pagave. Për këtë arsye jemi drejtuar Këshillit Bashkiak që ai



fond nga llogaria ekonomike ku është përcaktuar nga ministria të kalojë në llogarinë e pagave. Tek projektvendimi tjetër kemi miratuar nivelin e pagave ky është fond i akorduar nga Ministria e Financave për mbulimin e rritjes së pagave, sipas vendimit të fundit të qeverisë.

Mukades Gixhari . Keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë për fondin? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, pika 9-të e rendit të ditës.

Vendim nr.47. Miratohet me 16 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3961.Prot datë 18.09.2024 “Për miratimin e fondit të akorduar për mbulimin e rritjes së nivelit të pagave”, si dhe Relacionit Shpjegues të projektvendimit me Nr.3961/1 datë 18.09.2024.

Mitat Daja . O zysha e ke marrë me marsh shumë të shpejtë.

Mukades Gixhari . Ju pyeta nëse kishit ndonjë gjë. z. Mitat ju ishit kundra?

Mitat Daja . Nuk e di herën e parë si votova unë kundra apo pro? Tani nuk e di çfarë jam pro apo kundra se di? Kisha për të sugjeruar diçka ...

Mukades Gixhari . Unë pyeta keni ndonjë gjë, pastaj e hodha në votim më vjen keq tani.

Mitat Daja . Kundra nuk jam sigurisht jam pro, po doja të bëja një pyetje ndoshta kisha diçka për të sugjeruar. Unë nuk jam kundra jam pro sigurisht që jam pro.

Shpati Kolgega . Për pagat, pjesa e kategorizimit vjen nga Ministria ?

Mitat Daja . Ja këtë pyetje kisha dhe unë.

Edison Memolla . Ka një udhëzim që thotë minimumi ...

Mitat Daja . Duhet të vi nga Tirana që të na japësh leje të bëjmë pyetje këtë pyetje kisha dhe unë.

Mukades Gixhari . Nuk e morët fjalën nuk ma kërkuat.



Shpati Kolgega . Unë do shkoj atje ti do vish këtu herë tjetër edhe ke më shumë kases.

Mitat Daja . Jo se nuk pranon Veri.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 10, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të bashkisë Rrogozhinë”. Vazhdojmë po me z. Rezart Vogli dhe drejtoreshën juridike znj. Enkela Ballabani.

Enkela Ballabani . Për sa i përket projektvendimit të pagave kemi një vendim të ri nr.503 datë 01.08.2024 ku është bërë një klasifikim i ri për sa i përket grupimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore për efekt page. Keni bashkëngjitur tabelat për çdo kategori page duke filluar nga kryetar bashkie deri tek njësitë administrative nuk e di nëse keni ndonjë pyetje?

Erind Tosku . Kur hy në fuqi kjo nëse e miratojmë sot?

Enkela Ballabani . Atëherë sipas vendimit hyn në fuqi në Shtator.

Erind Tosku . Këtu mblidhen të gjithë funksionarët e bashkisë?

Enkela Ballabani . Në bazë të klasifikimit pika 6-të e VKM-së përcaktohet për sekretar të përgjithshëm për drejtor drejtorie, përgjegjës sektori, kryeinspektor, dhe për specialistët për sa i përket kësaj VKM-je nuk preket policia bashkiake sepse pritet që të dalë një vendim i ri të paktën kështu u tha që do ndërhyhet dhe tek policia bashkiake dhe punonjës të shërbimeve. Për sa i përket policisë bashkiake ne kemi patur një detyrim ligjor mirëpo kemi bërë një ndryshim me një rritje page që përcaktohet tek VKM-ja tjetër që është 328 / 2023 ku thotë kufijtë e pagave për punonjësit administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore do të jenë nga 40 mijë lekë deri në 47 mijë lekë të reja dhe ne për policinë bashkiake kemi bërë rritjen maksimale që na lejon VKM-ja e vjetër deri në 47 mijë lekë.

Erind Tosku . Po kemi bërë rritjen e pagës për policinë bashkiake.

Enkela Ballabani . Ajo ka qenë vetëm kategorizim jo rritje page.

Erind Tosku . Pastaj këtu janë roje, punonjës shërbimi, të gjithë këto përfshihen tek kjo pjesa e rritjes së pagave?

Enkela Ballabani . Po.



Mukades Gixhari . Pyetje tjetër para se ta hedhim në votim?Atëherë e hedhim në votim.
z. Mitat kishe ndonjë gjë?

Mitat Daja . Jam dakord me ty zysh.

Mukades Gixhari . Ok, faleminderit.

Mitat Daja . Mjafton ta thuash dhe unë jam dakord.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. 14-pro, 1-votë kundër.
Miratohet.

-Miratohet me 14 (katërbëdhjetë) vota pro, 1 (një) votë kundër, 0 (zero) abstenim, pika 10-të e rendit të ditës.

Vendim nr.48. Miratohet me 14-vota pro, 1-votë kundër projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3918.Prot datë 16.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të bashkisë Rrogozhinë”, si dhe Relacioni shpjegues i projektvendimit me Nr.3918/1.Prot datë 16.09.2024.

Mukades Gixhari . Kalojmë ne pikën 11, Informacion nga Drejtoria e Politikave Urbane dhe Sektorëve të saj, mbi punën e bërë për periudhën Janar-Korrik 2024. Drejtori i Politikave Urbane z. Tomorr Thartori. Përshëndetje z. Tomorr. Ta dëgjojmë pak drejtorin.

Mitat Daja . Kur do vijë koha që në Rrogozhinë të ketë një bulevard ose një rrugë me emër?

Edison Memolla . E kemi ngritur grupin e punës jeni po ju që do procedoni.

Mitat Daja . Nuk po flas për qytetar nderi po flas për një rrugë.

Edison Memolla . Për rrugë. Miratimi bëhet direkt nga Këshilli Bashkiak.’

Mitat Daja . A ka një hartë për këtë punë a është bërë një hartë?

Edison Memolla . Ju sillni propozimet e juaja për çdo rrugë ta hedhim në dëgjësë publike.



Tomorr Thartori . Harta është komplet sistem elektronik është tek adresa dhe emërtimi i rrugëve është tek sistemi i adresave.

Mitat Daja . Ka mundësi ne të bëjmë propozime për emra rrugësh?

Enver Memolla . Ato përcillen tek komisioni.

Mitat Daja . Ne bëjmë një propozim dhe komisioni e merr për bazë ne nuk marrim pjesë në komision ne jemi të pavarur.

Enver Memolla . E çon në komision kërkesën nuk ka gjë të pavarur edhe unë e çoj...

Edison Memolla . Një nga ato meqë e hape këtë temë është edhe i ndjeri ish kryetari i bashkisë nëse ju do e shihni të arsyeshme për një emër rruge.

Mitat Daja . Të bëhet emërtimi i rrugëve kryesore pastaj të lagjeve.

Silvana Aliu . Unë jam dakord por ka dhe emra të tjerë...

Edison Memolla . Ka tjetër? Jo unë jap një propozim hajde të...

Erind Tosku . Sa të informuar ose sa pozitiv kanë dalë këto nga problematikat e ndërtimeve se shoh lejet online ? Qytetari thotë do rri të merrem me leje online sepse unë kur të ashtu fillon ndërtimi shkon IMTV-ja pastaj thotë unë nuk di të aplikoj e kështu gjërash. Keni një informacion bashkia ka bërë një sensibilizim për të gjithë qytetarët dmth jo në Rrogohinë por në gjithë Bashkinë.

Tomorr Thartori . Tek faqja e Kryetarit të Bashkisë është postuar gjithë rregullorja si për deklaratat paraprake, si për lejet e ndërtimit, si për riparimet.

Erind Tosku . Ne vazhdojmë neglizhojmë tek kjo pjesa pse të bëhemi objekt për IKMT-në për policinë bashkiake kur për diçka 2 minuta shkojmë tek faqja e bashkisë.

Tomorr Thartori . Për aq sa lejohet është shumë komode me leje.

Edison Memolla . Atëherë janë ndërtuar rreth 100 shtëpi nga Fondi i Zhvillimit janë dhënë rreth 100 leje të reja që janë në vazhdim punimi. Në momentin që ke mbarua 60% të punimeve e ke



me këshill bashkiak, shkon urbanistika bën verifikimet. Ka dhe problematika nuk kemi shkuar akoma tek pjesa e gjobës.

Tomorr Thartori . Qytetarët dhe firma zbatuese nuk kanë probleme .

Edison Memolla . Ju ftojme kush ka problematikë të paraqiten në zyrat tona dhe merremi me këtë çështje.

Indrit Dedej . Ti nuk ke evidentuar gjë?

Tomorr Thartori . Kemi qenë në terren tek Kont...

Indrit Dedej . Nuk ka rëndësi i ke në rregull ti?- Për mua jo kam ankesa.

Tomorr Thartori . Po ankesa dorëzohet tek ne nuk mbahet për vete, se nga ta di unë që ke ankesë. Tani për aq kohë që firma nuk ka zbatuar projektin ne e detyrojmë ta zbatojë ose kalon firma me gjobë.

Indrit Dedej . Firma po nuk shkove ti...

Mitat Daja . Tani a ka një afat për mbarimin e këtyre shtëpiave?

Tomorr Thartori . Afati përcaktohet tek leja e ndërtimit.

Mitat Daja . Janë dhe disa të tjerë që nuk janë trajtuar fare.

Edison Memolla . Është problematikë e trashëguar është e vërtetë jo më larg se para disa ditësh i dërguam prapë kërkesë...

Mitat Daja . Mirë kërkesë por njerëzit janë jashtë .

Edison Memolla . Bashkia thjeshtë merr fondet dhe menaxhon ...

Enver Memolla . Një problematikë e madhe tek ne është mbivendosja , që ka krijuar probleme dhe në marrjen e lejeve të legalizmit. Ka një plan konkret bashkia apo pritet nga kadastra?

Tomorr Thartori . Me ligjin e ri 2020 është komplet pjesë e kadastrës, bashkia nuk ka të drejtë



as të firmosi as të lëshojë plane rievimi, ka drejtori kastile për përmirësimin e hartave që merren. Bashkia para 2020 përpilonte një plan rievimi dhe me dakordësinë e të gjithëve e dërgonte në kadastër sot është privatisht do bësh plan rievimi provat deklaratë tek noteri privatisht.

Indrit Dedej . Kam raste që ka shkuar privatisht personi dhe e kanë orientuar drejt gjykatës dhe ka 5-6 vjet për ndryshimin e hartës, imagjino tani që unë kam informacion shtëpnë nga “Shimtë” na del në “Bisht të Zhurit” ai nuk ka kokërr leku hajde ti tani të shkosh në gjykatë dhe kështu ndodh me popullin se nuk ka shans t’i bëhet shtëpia me letra kur ka mbivendosje.

Edison Memolla . Ti bën aplikimin tek e-albania ne jemi dashamirës të ndihmojmë për ta bërë aplikimin sa më të saktë, jemi munduar të ja plotësojmë dosjen...

Indrit Dedej . Ti nuk ke mundësi me e ndihmuar.

Edison Memolla . Ne ja plotësojmë dosjen që ta ketë të saktë.

Hekuran Xhani . Ne morëm një vendim këtu për 17-familje që nuk kishin përfituar nga fondet e tërmetit, deri ku ka shkuar ky proces?

Rezart Vogli . 25 familje, është bërë procedura besoj që nga mesi i Dhjetorit shpallet fituesi edhe është një projektvendim i ngjashëm me atë të digës që ne kërkuam financim fondesh nga projekti.

Hekuran Xhani . Dmth është miratuar nga qeveria, në rregull.

Mukades Gixhari . E falenderojmë z. Tomorr dhe vazhdojmë me pikën e radhës. Informacion mbi masat e marra nga Drejtoria Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes për pastrimin e kanaleve të para të dyta e të treta dhe përgatitja e tyre për dimrin. Drejtori i Bujqësisë z. Elton Xhani. Përshëndetje z. Elton!

Elton Xhani . Ju ka sjell relacionin shoqëruar dhe me fotografi nëse doni dhe jua lexoj.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje për drejtorin e bujqësië?

Erind Tosku . Është bërë punë, dëgjova nga kryetari që paska ardhur skrepi. Për këtë dimër jeni të përgatitur për të mos të patur probleme nga koha, i keni vënë pak a shumë gjërat në kontroll për të shmangur ndonjë përmbytje?



Elton Xhani . Janë bërë shumë pastrime në njësinë administrative Gosë dhe këtu në Rrogozhinë.

Edison Memolla . Dihen problemetikat që ka zona e Gosës kanali K5.

Enver Memolla . Një pyetje për drejtorin, ky raportim është deri në muajin Gusht 2024, Janar-Gusht?

Elton Xhani . Po.

Enver Memolla . Sa është fondi që ke [asur në përdorim në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve?

Edison Memolla . Nuk ka drejtoria fond të deleguar këto janë më mjetet e bashkisë dhe në bashkëpunim me Bordin e Kullimit Durrës nuk është agjenci që të menaxhojë...

Enver Memolla . Në buxhet është parashikuar një buxhet për mirëmbajtjen e kanaleve...

Edison Memolla . Nuk e çojmë në tenderim...

Enver Memolla . Jo tenderim.

Edison Memolla . Ne blejmë karburant dhe e çojmë me mjetet tona, që të bëjmë sa më shumë punë dhe pa kosto.

Enver Memolla . Të përgëzoj për informacionin që ke sjellë por e ke pa shifra.

Elton Xhani . Ne jemi munduar të prekim të gjithë problematikat më të rëndësishme që janë më të domosdoshme, tani me ardhjen e skrepit të ri siç e tha dhe kryetari do vazhdojmë...

Enver Memolla . Nga Tetori 2023 - 26 Shtator 2024 përgjatë Vijës së Zogut, sa kanale të dyta të treta ke pastruar?

Elton Xhani . Tani e para që do vijë skrepi i ri, tek Vija e Zogut do shkojë.

Enver Memolla . Jo flas tani lëre çfarë do shkojë.

Edison Memolla . Do bëhet gjithë zona Sinaballaj pastaj do dalim në Luz për të gjithë problematikat.



Sokol Gosa . Ton kur the për skrepin që parë mu kujtua ka qenë një skeç para 30-40 vjetëve...

Enver Memolla . Kryetari e tha me të drejtë që pika e Gosës ka qenë një pikë shumë e nxehtë por mos harrojmë që edhe Kanali i Zogut nuk është shumë i ftohtë. Vjen Tetori dhe atje bëhet batërdia.

Elton Xhani . Për dy tre ditë punë skrepi i ri mbaron.

Erind Tosku . Mbajë shënim.

Enver Memolla . Atje janë 8 blloqe kullota, që kanë dy rreziqe një e kishin të mbartur lumi Shkumbin që fillon e gërryen çdo ditë dhe vazhdon historia. Populli tek këshilli vjen, sepse nesër do mbledhësh taksa kështu që merreni parasysht mirë këtë pjesë.

Elton Xhani . Të paktën mbledhjen e ardhshme është realizuar...

Enver Memolla . Se mos biesh sëmurë herë tjetër.

Indrit Dedej . O Saimir në rregull je ti me kanalet?

Saimir Cani . Po.

Mukades Gixhari . Tani mbledhjes ju bashkua dhe këshilltari z. Isa Halili. Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, Informacion mbi punën e bërë nga Sektori i Pyjeve dhe përmisimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë. Përgjegjësi i Pyjeve z. Artur Kaja.

Artur Kaja . E nderuar zonja Kryetare të nderuar Këshilltarë. Sektori i pyjeve në Bashkinë Rrogozhinë e organizon dhe drejton punën e tij bazuar në ligjin “Për Pyjet” dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në funksion të tij. Qëllimi kryesor i punës sonë është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës të tokës ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese të ekuilbrave të mjedisit natyror biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik si detyrime në interes kombëtar e ndërkombëtar. Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar në nivel vendor me attribute menaxhuese, mbrojtëse, kontrolluese dhe parandaluese të veprimtarive të paligjshme në fondin pyjor bashkiak. Sektori i pyjeve në bashkinë Rrogozhinë ka në organikën e tij një specialist pyjesh me arsim të lartë që është dhe shefi i këtij sektori si dhe 3 rojtarë pyjesh në zonat pyjore. Ky sektor është i përfshirë brenda drejtorisë së Bujqësisë dhe e



organizon punën e tij në bazë të planeve të punës vjetore dhe mujore të hartuara për këtë qëllim. Nga ana e sektorit të yjeve sipas planit të punës organizohen kontrole në terren për parandalimin e prerjeve të paligjshme zënien e fondit pyjor gjuetisë së paligjshme mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe për çdo rast harton akt kontrollet dhe procesverbale nëse ka shkelje të ligjit të pyjeve. Kontrollat organizohen dhe në drejtim të shtijes së materialit drusor nga persona që vijnë nga bashkitë e tjera dhe tregëtojnë material drusor në bashkinë tonë. Në rastet kur ka pasur konflikte shërbimi pyjor ka kërkuar ndihmën e policisë bashkiake dhe asaj të rendit.

Në lidhje me mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e paligjshme theksojmë se puna e bërë nga ana e sektorit të pyjeve ka qenë e mirë kjo dhe për faktin se pyjet në bashkinë Rrogozhinë pjesa më e madhe janë pyje halorë të cilat nuk preferohen nga popullata për ngrohje.

Në lidhje me mbrojtjen e pyjeve nga zëniet e paligjshme të fondit pyjor pothuajse nuk kemi patur asnjë rast të tillë.

Në lidhje me mbrojtjen e yjeve nga zjarret theksojmë se nga ana jonë çdo vit në bashkëpunim me Shërbimin Zjarrfikës, Policinë e Rendit dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore hartohen plane operacionale ngrihen skuadrat zjarrfikëse në çdo fshat dhe Njësi të Qeverisjes Vendore. Gjatë këtij viti kanë rënë 3 zjarre në 2 zona pyjore një me datë 25 Korrik në Kryeluzaj dhe me datë 6 dhe 19 Gusht në Mushnikë të cilat me ndërhyrjen e shërbimit zjarrfikës dhe shërbimit pyjor arritën të fikën.

Përveç mbrojtjes së pyjeve nga ana e sektorit të pyjeve ofrohen dhe disa shërbime siç janë:

1. Dhënia me qira e fondit pyjor dhe kullësor bashkiak. Dhënia me qira e fondit pyjor dhe kullësor është e mbështetur në Ligjin nr.57/2020 “Për Pyjet” neni 25 “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar” dhe akteve të tjera nënligjore. Aktualisht janë 6 kontrata për dhënie me qira e fondit pyjor dhe kullësor bashkiak nga viti 2013 dhe aktualisht me një vlerë prej 2.684.720 lekë.

Një shërbim tjetër që ofron sektori i pyjeve është dhe plotësimi i banorëve të bashkisë me material drusor sipas kërkesave, Përveç shërbimeve që ofron sektori i pyjeve ka nevojë dhe të financohet dhe për disa shërbime që janë : Nevoja për karburant, nevoja për kancelari, planifikimi i një fondi për punëtorët që do të marrin pjesë në fikjen e ndonjë zjarri të mundshëm që mund të bie në pyje. Nevoja për investime në kryerjen e punimeve sipas projektit të miratuar “Për hapje korridoresh dhe për të kryer pyllëzime”.

Mitat Daja . A ka Bashkia fond tokash që mund të jepen me qira? A keni krujuar një fond dhe sa është fondi?

Artur Kaja . Unë e kam paraqitur fondin që duhen të jepen me qera nga ana e bashkisë sepse po të lexosh dhe ligjin për pyjet citoj : Të ardhurat që krijohen nga bashkitë nga dhënia në përdorim e fondit pyjor përdoret për investime në pyje që do të thotë që ne duhet të japim sa më shumë sipërfaqe pyjore.



Mitat Daja . Edhe njëherë tjetër se unë nuk kuptoj shumë gjëra ma thuaj më shkoqur, bashkia ka një fond tokash për dhënie me qera?

Artur Kaja . Po, ka.

Enver Memolla . Të erdhi para dy mbledhjesh.

Artur Kaja . E kam paraqitur një herë dy herë.

Mitat Daja . E di unë nuk po e bëj se nuk e di, unë hap sytë këtej nga kodrat i ke gjithë ullinj e gjithë pemtore. Tani ky është fond Bashkie apo privat i njerëzve? Se çfarë ndodh, kur ndodh një zjarr apo një problem tjetër vjen një banor siç ka ndodhur para 1 viti, se kishte bërë kërkesë ai që më janë djegur ullinjtë edhe arsyetimi i bashkisë ishte që ai nuk ka as NIPDT as nuk është i regjistruar kështu që nuk përfiton asgjë. Ju si sektor keni krijuar një fond që ta dimë që ky është fondi dhe në se nuk e merr dot ti sektori pyjor ka një polici bashkiake një sektor tjetër juridik që punon me këtë punë e krijon dhe thotë zotëri kjo toka që thurur ti është me qera është pronë e shtetit ti do e marrësh me qera ose është personale e atij private le ta marrë ta gëzojë sepse është pronar po nëse nuk është pronar është fond i bashkisë, këtë po pyes.

Artur Kaja . Atëherë të gjithë tokat që ne shikojmë, janë toka bujqësore të refuzuara...

Mitat Daja . Janë toka të lira?

Artur Kaja . Ka dhe të lira ka dhe të zëna.

Mitat Daja . Juridikisht janë të lira, realisht janë të zëna nga ana ligjore janë të lira?

Artur Kaja . Pjesa më e madhe janë të zëna nga banorët e zonës.

Mitat Daja . Ato i kanë zënë jashtë ligjit nga ana ligjore janë të zëna apo janë të lira?

Artur Kaja . Ato janë të zëna.

Mitat Daja . Nëse bashkia supozojmë do të bëjë një aerodrom atje , ja pret ullinjtë të gjithë atyre fshatarëve dhe mbaron punë apo jo? Marrim një shembull.

Artur Kaja . Atëherë ne projektvendimet që kemi paraqitur në këshill bashkiak kemi paraqitur



dhe për tokën bujqësore dhe për pyjet. Tokat ne kemi parashikuar që ti japim në përdorim sipërfaqet që janë të lira ose ato sipërfaqe që banorët i kanë zënë këtu e 20 vjet edhe ti kompletojmë me një kontratë edhe bashkia të marri ...

Mitat Daja . Nuk po thotë njeri t'i presim ullinj të po them pse nuk paraqitet në këshill bashkiak fondi i tokave që mund t'i lejohet bashkisë që t'i japë në përdorim.

Artur Kaja . Është paraqitur dy herë dhe nuk ka kaluar.

Mitat Daja . Po çfarë ka që nuk kalon?

Mitat Daja . Ti sille të paktën të detajuar.

Artur Kaja . Atëherë unë flas për pyjet se shumë herë jemi ngatërruar me bujqësinë e të tjera gjëra.

Mitat Daja . Nuk ke pse ngatërrohesh fare.

Artur Kaja . Kam marrë dhe projektvendimet e bujqësisë.

Isa Halili . Tek projektvendimet e tjera të bujqësisë që janë marrë këtu nuk kanë kaluar sepse ju nuk keni patur nëse e mban mend relacion të detajuar.

Artur Kaja . Sipërfaqet pyjore në bashkinë Rrogozhinë jepen në përdorim për disa qëllime si turistike për mbarështrim faune për vendosjen e fotovoltaikeve.

Edison Memolla . Atëherë Bashkia disponon disa toka ligjërish të lira si bujqësore si pyjore. Ne i kemi paraqitur dy herë më duket në mbledhjet e radhës nuk u kaluan për arsye të ndryshme. Herës tjetër do përgatiten më mirë që mbledhjen e ardhshme ose vitin e ardhshëm t'i jepet e drejta kushdo që ka mbjellë ullinj apo do ta marri me qera.

Isa Halili . Për të qenë korrekt dhe me ata që na dësgjojnë problemi këtu nuk ka qenë pse nuk i kemi kaluar ne , ka shumë lidhje sepse njeriu që është përgjegjës në këtë rast personi që sapo foli në mbledhjet e tjera kur ne kemi kërkuar thjeshtë dhe vetëm informacion për atë dikaster që ai mbulon ai nuk ishte zero informacion. Dhe unë po e pyes prap pas dy muajsh në lidhje me sipërfaqen e pyjeve që ai na hodhi hipotezë për të bërë në lidhje me sipërfaqen e pyjeve kryesisht në zonën e Spillesë mos qofsha i gabuar. Dhe tha janë të lira dhe ne kërkuam thjeshtë dhe vetëm



informacion në lidhje me sipërfaqen e pyjeve sikurse e kërkoi tani në këto momente për projektvendimin e ditës së sotme në lidhje me shërbimet që ka ofruar ky dikaster që zotëria mbulon në lidhje me karburantet sa numri si? Sepse ne ketë duam të dimë se nuk jemi të vetëdijshëm realisht se ... për të gjitha këto shërbime që me demokanë qenë në projektvendimin që paraqitet ditët e sotme prakonkretisht për të qenë konkret sepse ju lexoni një gjë aty dhe këtu askush nuk e ka vëmendjen as vetë ju nuk u kuptoni çfarë jeni duke thënë. Z. Artur kam qejf të shoh në sy siç parapëlqej të më shohësh në sy, tani jam duke thënë edhe një herë tjetër para dy muajsh në se të kujtohet shumë pyetje të cilët ne i kemi bërë këtu në mbledhje këshilli ti nuk i kë dhënë asnjë përgjigje...

Artur Kaja . Ashtu mendon ti.

Isa Halili . Mendoj unë?

Artur Kaja . Është mendimi jot.

Isa Halili . Ky nuk është mendim është konstatim.

Artur Kaja . Nëse ju vjen një projektvendim dhe nuk lexoni aktet ligjore ku është mbështetur janë bashkëlidhur atij projektvendimi...

Isa Halili . Unë jam duke të pyetur konkretisht sa kilometra katror pyje ka bashkia e Rrogozhinës në të cilat sa janë të lira sa janë për t'u shfrytëzuar dhe sa...?

Artur Kaja . Këtë pyetje me kilometra katror nuk e kuptoj, Shqipëria është 28 mijë kilometra katror.

Edison Memolla . Ty të duhet sa sipërfaqe pyje kemi ne?

Artur Kaja . Tani po sa sipërfaqe pyje ka Bashkia? - Ka 1850 ha pyje nga këto 128 ha i ka shkëmbore...

Isa Halili . Dokumentacionin dua jo me fjalë.

Artur Kaja . Herën tjetër...

Isa Halili . Pikërisht ke thënë që radhës tjetër para dy muajsh do na sjellësh informacion në



lidhje me këtë gjënë dhe nuk kam qenë vetëm unë dhe ti në këtë mbledhje kemi qenë disa persona që kemi marrë pjesë.

Artur Kaja . Zotëri e para ...

Isa Halili . Jo një sekondë sepse koha jote ka përfunduar për hir të vërtetës, sepse ti zotëri ke premtuar dhe ke thënë këtu sepse këto janë të gjitha të filmuara dhe janë fakte ke thënë kur do vi në mbledhjen tjetër do ju jap informacion në lidhje me pyjet që ti nuk i dhe atë ditë, që kanë të bëjnë me pyjet dhe jo vetëm. Nuk ka lidhje me rendin e ditës për atë rend dite që ka qenë atëherë.

Artur Kaja . Në rend dite kam këtë dhe për këtë po vi.

Isa Halili . Edhe për atë që ke, më thuaj pak çfarë shërbimesh nga ato që ti sapo theksove ti ke dhënë për qytetarët që i ke ardhur në ndihmë, konkretisht çfarë? Për shembull po flas për Njësinë Administrative Sinaballaj çfarë shërbimesh keni dhënë ju?

Artur Kaja . Sepse nuk është kërkuar asnjë lloj shërbimi nga ...

Isa Halili . Dmth nuk është kërkuar?

Artur Kaja . Po.

Isa Halili . Në Njësinë Administrative Kryevidh çfarë?

Artur Kaja . Ku është kërkuar shërbim është ofruar. Nuk e di çfarë nënkupton me shërbim tek pyjet?

Isa Halili . Ata shërbime që ti sapo i theksove që i ke ofruar.

Erind Tosku . Po jep një narrativë ndaj drejtorit të bujqësisë, tani jepi pyetje konçize që ai të përgjigjet dhe të bëjmë dhe ne pyetje.

Isa Halili . Atëherë në qoftë se nuk i keni dëgjuar ende pyetjet unë po i ripërsëris...

Erind Tosku . Po nuk po e kupton pra...

Isa Halili . E kupton pse nuk e kupton? Problemi ka qenë këtu sepse atëherë ne ndoshta nuk



është problem se dhe unë po të isha në vend të tij nuk kisha informacionin e duhur për pyetjet tona por na është thënë që për këta pyetje me demokraci u morën në konsideratë pyetjet tona dhe u shënuan zotëria në fjalë duhet të jepte informacion në mbledhjen që ne kishim për këtë gjënë sepse të gjitha pyetjet që ne i drejtuam në atë periudhë nuk morën një zgjidhje nuk morën një përgjigje. Dhe këto përgjigje nuk po jepen as ditën e sotme që ka dy muaj nga kjo ka qenë në mos gaboj në Korrik pra që është bërë mbledhja në lidhje me këtë pjesë.

Erind Tosku , Të marrë masa administrative bashkia në lidhje që nuk i jep përgjigje këshilltarit edhe mbaroi puna.

Edison Memolla . Çfarë duhet tjetër jo mbledhjen e radhës por më shpejt do të shoqëroj nesër ose pasnesër dhe të jap informacionin e saktë ...

Artur Kaja . Dhe për fondin e tokave kam raportuar në këshill.

Enver Memolla . Kryetare shumë herë të kam kërkuar për mbajtjen e rregullit në mbledhjen e këshillit bashkiak për të mos kohëzgjatje, e kam theksin që të flasim për rendin e ditës e para punës. E dyta, unë edhe kur isha si kryetar grupi në atë kohë kam rënë dakord që çdo anëtar i këshillit bashkiak ka të drejtë të bëjë kërkesë me shkrim si në emër të grupit, si në emër të vet me shkresë zyrtare drejtorisë përkatëse. Edhe këtu ne pastaj kemi të drejtë të ngrejmë zërin pse kërkesa me numër proteokol kaq që ka bërë sekretari i këshillit nuk ka përgjigje. Jo të gjitha që mund të thuhet këtu mund të marrin përgjigje edhe diçka tjetër nuk po funksionon mbledhja e komisioneve. Kryetari i komisionit të bujqësisë mbron relacionin e vet çfarë është diskutuar në mbledhjen e komisionit dhe pastaj kishim diskutimet tona më të pakta. Për sa i përket asaj që thotë Mitati fondi i tokave ka ardhur tre herë në këshill dhe arsyeja që unë kam kundërshtuar sepse ishte cituar që për tokat që thotë që janë ulla të zëna paligjërish nga banorët, ç'ka do të thotë këtu duhet të ndërhyjë bashkia se informacioni është i paplotë për disa që do të thotë sipërfaqja 0.5 ha nuk marrin dot kontratë qeraje në bashkinë Rrogozhinë me ligjin e ri. Ato kanë qenë nismë e projektvendimit të këshillit të ministrave që ishin 99- vjeçare me 1 euro m² sa ka qenë dhe tani është 0-1 ha tokë. Dhe arsyeja që fondi është kthyer mbrapsht dhe tani vijmë tek rendi i ditës ishte për këtë arsye paligjshmëria poshtë, sepse këshilli bashkiak nuk mund të miratojë një fond pyjesh kur është e paligjshme zënia atje sepse mund të shkojë për ndjekje penale zbatuesin. Kjo është ajo çfarë unë i kam kërkuar informacion drejtorisë së bujqësisë. Ndaj kam kërkuar që në atë kohë duke marrë shkas nga ky handicap që është krijuar midis anullimit të ligjit të ri, duhet një preventiv të na vijë ne si këshill bashkiak të jemi në dijeni se sa hapësira nga fondi pyjor apo bujqësor janë zaptuar ose kanë ngelur peng i atij ligjit të mëparshëm. Se të gjithë e kanë nga një shkresë në dorë, deri në 2021 kanë paguar taksat deri në anulimin në 2019. Kjo



duhet kërkuar me shkresë në dashtë ta kërkojë kryetari i grupit, në dashtë shkresë zyrtare në emër të vet ta përcjelli sekretari i këshillit. Po nuk mund të zgjasë mbledhja e këshillit se na kujtohet një pyetje ne dhe të vijmë nesër prap, drejtohem me shkresë zyrtare si bashki çdo lloj institucioni dhe marrim përgjigjen, aty po i pari që ngre zërin që ska ardhur përgjigja është komioni përkatës dhe e dyta këshilli bashkiak nuk kemi pse zgjatemi tani erdhi nuk erdhi, faleminderit.

Erind Tosku . Për rendin e ditës, kam një pyetje për gjigje me z. Artur, aktualisht kemi 6 kontrata qeraje...

Artur Kaja . Atëherë tre kontrata janë në Spille, një shtë në Domen dhe dua të theksoj që kontrata kanë qenë lidhur nga ish drejtorja e shërbimit pyjor Kavajë në 2013 edhe janë 4 në Spille, një në Domen, një në Stërbeg në pyllin e Bedenit.

Erind Tosku . Në rregull, tani ke thënë përveç shërbimit që ofron sektori i pyjeve ka disa shërbime që janë nevoja për karburant nevoja për kanceleri planifikimi i një fondi punëtorësh për zjarre të mundshme. Unë besoj që në raste zjarri është zjarrfikësja ushtria dhe banorët e zonës që ndërhyjnë, besoj që t'i rishikoni këto nevoja që keni se nevojë për karburante ju nuk keni mjete. Për periudhën e dimrit lënda drusore për shkollat .

Indrit Dedej . Ti zotëri nuk meriton asnjë lek... ra në Sinaballaj nuk ke shkuar apo nuk kishte naftë.

Edison Memolla . Ka shkuar zjarrfikësja, kemi sjellë dy herë helikopterin.

Artur Kaja . Pyjet janë të gjithë në male në kodra. Dhe në qoftë se ju nuk miratoni fondin pyjor atëherë ato 5 lekë që marrim nga fondi pyjor i bëjmë rrugë.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Artur vazhdojmë me pikën tjetër, Informacion mbi punën e bërë për përgatitjen e vitit të ri shkollor nga Drejtorja e Arsimit dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse pranë Bashkisë. Drejtori i Arsimit z. Orges Tosku dhe drejtoresha e shërbimeve mbështetëse znj. Valmira Troka. Përsëndetje!

Orges Tosku . Përsëndetje të gjithëve! Në mbashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve mbështetëse përpara fillimit të vitit të ri shkollor 2024-2025 kemi inspektuar të gjithë institucionet arsimore që janë në varësi të bashkisë Rrogozhinë. Pas verifikimeve në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve kemi konstatuar disa problematika ndër to janë:



Pastrimi i ambienteve të brendshme e të jashtme , riparime pajisje hidrosanitare, riparime elektrike, lysterje e ambienteve ku është e nevojshme, zëvendësim i xhamave të thyer, kemi bërë shpërndarjen e detergjentëve, mjetet sportive do dalin shumë shpejt. Gjithashtu policia bashkiake ka qenë prezente.

Mukades Gixhari . Atëherë ndonjë pyetje për...

Erind Tosku . Riparimi i pajisjeve hidrosanitare në tualete. Institucioni që unë jap mësim dhe nga informacioni që kam nga disa shkolla të tjera në gjimnazin “Haxhi Qehaj” aktualisht punon një tualet, besoj jeni në dijeni po bën një vit nuk është marrë asnjë masë. Përtej konstatimeve ardhjeve të drejtorëve nuk është marrë asnjë masë besoj që jeni të informuar. Sistemi elektrik nuk është parë nga teknikët elektrik që ka bashkia çelësa drita. Nëse do ta shohim në këtë formë tek klasa ku jap unë mësim nuk është parë. Detergjentet nuk janë pajisur shkollat detergjentë dizinfektimi ky është fakt. Ambientet sportive përjashtë të territorit të gjimnazit tonë janë të prishur, rrjetat janë të prishura nxënësit mund të dëmtohen. Kështu që unë këtë kisha tek pjesa e informacionit që kam për shkollën kështu që ...

Mitat Daja . Për sa i përket kam folur dhe me Valin është një shkollë atje në Gosë të Vogël e harruar , sipas informacionit që kam ato mësuesit atje kanë blerë bojë dhe e kanë lyster vetë, e para. E dyta xhamat e thyer...

Edison Memolla . Janë riparuar xhamat.

Mitat Daja . Mund të jenë riparuar tani shpejt.

Edison Memolla . Para se të fillojë shkolla.

Mitat Daja . Shkolla është për faqe të zezë, është shkollë e harruar quhet. Është edhe një shkollë këtu që shkoj një herë në javë unë më keni çuar atje për të ju sjell informacion juve këtu kryetarit të bashkisë e të tjerëve që janë këtu. S’ka shkumësa thotë kjo mësuesja këtu por i vjen turp ta thotë. Kemi një shkollë në mes të qytetit aty quhet “Qamil Gjuzi” edhe ajo shkollë e harruar quhet, kondicioneri njëherë funksionon njëherë jo. Në qoftë se ju thoni nuk është marrë në dorëzim na nxirri jashtë, na gjej një ambient tjetër sepse kur fillon dielli tek ato klasat jo që mësim nuk bëhet dot por nuk duron dot as erën e trupit tënd se fillon njeriu kullon... Jeni futur ndonjëherë në serë, kush ëshë futur e di, ato që nuk janë futur në serë nuk e kuptojnë dot se , s’është faji im. Pra nëse keni marrë masa unë besoj që masat janë më pak se gjysmake, pastaj është dhe një tjetër gjë sepse duke toleruar gjithmonë i bie që të jemi gjithmonë dakord me atë që



bëhet. Do vazhdoni tek kopshti me komandime apo do caktoni një drejtues aty tek kopshti, tek kopshti i Rrogozhinës, ka kaç kohë nuk zëvendësohet një drejtoreshë. Kaq e pamundur është për t'u zëvendësuar një drejtoreshë?

Orges Tosku . Drejtoresha është zëvendësuar.

Mitat Daja . Mirë drejtoreshat e shkollave i keni çelik rreth partisë dhe të pazëvendësueshme, pra keni bërë në mend që të bëni ndryshime?

Edison Memolla . Është bërë ndryshimi, është mbyllur në bazë të procedurës ligjore është emëruar personi në fjalë.

Mitat Daja . Është emëruar nuk është më me komandim?

Edison Memolla . Është emëruar, ne të bashkisë i emërojmë.

Mitat Daja . Është hapur një konkurs atje tek emërimi i drejtoreshës?

Edison Memolla . Është hapur është bërë dhe thirrja.

Mitat Daja . Se mos bëhet si ajo hapet konkursi mbyllet konkursi mos e keni bërë ashtu.

Edison Memolla . Tani nuk do e kthejmë në muhabet.

Mitat Daja . Nuk shoh që janë marrë masa për arsimin thjeshtë është lënë çdo gjë e lirë.

Isa Halili . Teksa dëgjova Gesin në lidhje me problematikat që ka ky sezon arsimor, fatmirësisht por edhe fatkeqësisht para një viti këtu në Shtator është diskutuar para një viti dhe ishin po të njëjtat problematika. Pyetja ime është konkretisht në shkollën “Zenun Isufi” në Sinaballaj çfarë i është ofruar nga Bashkia Rrogozhinë në lidhje me mbarëvajtjen që ka të bëjë nga bashkia përgjatë një viti kalendarik?

Edison Memolla . Gjatë vitit është sjellë baza materiale, detergjentët, mirëmbajtja e shkollës.

Isa Halili . Atëherë më duhet të ju them që baza materiale nuk ka shkumësa.

Gezime Met-hasani . Është e vërtetë edhe kam ngritur zërin edhe vjet ...



Isa Halili . E dini çdo të thotë të mos ketë një shkollë shkumës, është njëlloj sikur të shkosh për një ndeshje futbollit dhe të thuash nuk kemi top, se me çfarë do luash nuk e di.

Mukades Gixhari . Të dëgjojmë pak drejtoreshën e ZVA-së znj. Alime Hoxha.

Alime Hoxha . Për shkumësat është përgjegjësi e zyrës, ne kemi bërë kërkesën por na është thënë që nuk është hedhur tenderi dhe presim të na vijë.

Edison Memolla . Isa edhe pse nuk na takon do merremi ne nga sot që ta sigurojmë këtë pjesë.

Isa Halili . Pyetja tjetër konkrete është në të gjitha shkollat që mbulon Bashkia e Rrogozhinës, konkretisht nga vjet nga gjithë ato problematika që kanë patur në lidhje me infrastrukturën dhe jo vetëm, uji që konstatuam që më shumë se 95 % e shkollave nuk kishin ujë, problematikat e bravave që ishin në atë kohë, kishte dhe nga ato shkolla që kishin probleme me çatinë. Unë dua të di konkretisht, tek shkolla e Kryevidhit, tek shkolla e Gosës kur themi për Gosën flasim për Njësinë Administrative Gosë, çfarë është bërë gjatë këtij viti konkretisht kë keni rregulluar nga situata e cila ka qenë që nga Shtatori i vitit 2023?

Orges Tosku . Atëherë në Gosë të Vogël janë riparuar xhamat, janë riparuar dhe gjithë tualetet. Gjimnazi në Gosë të Madhe është shkollë e re.

Isa Halili . Në Kryevidh çfarë është bërë konkretisht?

Edison Memolla . Në Kryevidh është shkollë e re dhe në Stërbeg është lyster pastruar është mirëmbajtur dhe është çuar bazë materiale.

Isa Halili . Një nga elementët kryesorë me të cilët sepse presupozohet që janë fëmijë deri në moshën 14-15 vjeç është uji. Kush shkollë është mbuluar është rregulluar sistemi i ujit që nuk e ka patur dhe e ka konkretisht, cila shkollë nuk e ka pasur nga vjet dhe e ka këtë vit?

Edison Memolla . Rrogozhina ka ujë 24 orë, Njësitë Administrative janë me depozita furnizuese sespe nuk kanë kaluar akoma 24 orë, depozitat janë të vendosura uji shkon.

Alime Hoxha . Në të gjithë shkollat ka ujë por me depozita.

Edison Memolla . Nuk është me presionin e duhur siç e kemi në Rrogozhinë, por në Lekaj dhe në Gosë janë duke u bërë ujësjellësat e rinj që do jenë... Një herë në muaj bëhen komplet analizat



e ujit edhe sillen çdo institucion i sjell në bashki nëse doni jua bashkëngjisin.

Isa Halili . E di pse e kisha më tepër shqetësim këtë gjë, jo më larg se pardje në një bisedë as nuk e njihja as më njihje tha ku po shkon realisht po bëj letrat me ikur tha se jetonte andej nga zona e Stërbegut për shkak se kushtet e sigursië së shkollës atje dhe jo vetëm ku do çoj fëmijët atje nuk i kanë fëmijët dhe prandaj dua të largohem. Është problem nuk është vetëm i juaji ka qenë se ky nuk është një problem që ka qenë debati i 1,2,3,5 apo 10 viteve ky është një problem 30 vjeçar. Por jo ajo që më shqetëson Kryetar është fakti që unë shoh konstatoj përditë nga njerëz sepse jetojmë në një komunitet shumë të vogël, të cilët kanë problematika që janë aq të thjeshta aq bazike që me pak punë, me pak durim dhe me shumë pak zemërgjerësi mund të bëjmë gjëra të mëdha realisht po flasim për gjëra imediate bazike. Sepse më vret qasja që këtu nuk krijohen kushtet bazike që të cilat nuk meritojnë as vëmendje as kohë në 2024 për të diskutuar pastrimi i shkollave, lysterja e shkollave, uji në shkollë, janë gjëra aq bazike aq të thjeshta. Më shqetëson fakti sepse largimi i njerëzve është një gangrenë e madhe alarmi që ka prekur këtë vend dhe që pasojat po i vuajmë dhe do i vujamë nga dita në ditë ata pak njerëz që kanë menduar të jetojnë këtu. Pra është një problem që mbase është i madh por lind nga gjërat shumë të vogla që ne mbase nuk i vejmë në dukje ose mbase mund t'i anashkalojmë por që janë shumë imediate se një prind kur shikon që fëmija vet nuk ka të drejtat më minimale për t'u arsimuar dhe për të patur kushte në ambient që duhet të ketë është një problem i jashtëzakonshëm dhe nxitje e madhe që largohen nga ky vend. Dhe largimi i këtyre njerëzve ku në Stërbeg ku në Sinaballaj, ku në Gosë ku në Rrogozhinë ka sjellë këtë situatë në të cilën ndodhemi sot që papunë mësues këtë vit kanë përfunduar në rrugë se nuk ka nxënës. Ndoshta nuk e di mund ta quani problem shumë të madh por unë...

Edison Memolla . Dakord jemi , ne jemi e vetmja bashkia që janë bërë 8 shkolla të reja, tani ...

Isa Halili . Dakord janë bërë shkollat e reja unë di të them një gjë do merrem gjërësisht me këtë sepse para një viti për këto gjëra dhe unë jam i vetëdijshëm që nuk është bërë asnjë lloj përpjekje...

Edison Memolla . E ke gabim.

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak znj. Silvana Aliu.

Silvana Aliu . Tek shkolla tjetër keni bashkuar një minibashki të vogël të gjithë fëmijët në një klasë, asnjëri nga ju të paktën të sillte një nxënës këtej. Unë po them që në qoftë se do mblidhni të gjithë komunitetin rom dhe egjiptian dhe ato fëmijë që janë probleme sociale në një shkollë



ok. Nëse do merren masa ekziston një vendim që ka miratuar...

Edison Memolla . Është një vendim i këshillit bashkiak më përpara...

Silvana Aliu . Vëre në zbatim.

Edison Memolla . Është vënë në zbatim prandaj jemi në atë gjendje sepse është vënë në zbatim.

Silvana Aliu . Nuk është vënë në zbatim sepse komuniteti rom dhe egjiptian është i shkollës matanë dhe nuk ka pranuar këtë vit as edhe një, i ka marrë për dore dhe i ka sjellë tek ne.

Edison Memolla . Kjo është një çështje që ne nuk dimë të japim përgjigje, unë e di që është një vendim i këshillit bashkiak që ka bërë ndarjen e dy shkollave fshat qytet.

Silvana Aliu . Atëherë duke filluar nga viti që vjen të merret me lagje.

Alime Hoxha . Nuk është e ndarë dhe nuk mund ta ndajmë, prindi ka të drejtë ta zgjedhë ku do ta çojë fëmijën nuk është fare obligim biles tani që bëhet aplikimi nga e-albania ne nuk kemi asnjë lloj të drejte që të ja kufizojmë zgjedhjen e shkollës, prindi e zgjedh vetë.

Silvana Aliu . Kur është ndarë shkolla se në bazë të atij vendimi ndodhi ndarja e shkollës.

Alime Hoxha . Çfarë ndodh sot?- Ti sot e di shumë mirë që fëmijët i regjistron prindi apo jo?

Silvana Aliu . Bashkoje shkollën.

Alime Hoxha . Në rregull, bashkojmë shkollën e di ti si funksionon pastaj.

Enver Memolla . Di që është një vendim i 2000, sekretari të na e gjejë të na e bëjë të pasqyruar më shumë për informacion.

Alime Hoxha . Edhe sikur të ekzistojë ta hedh poshtë ligji i regjistrimeve ke të drejtë të zgjedhësh nuk ja ndalon dot.

Isa Halili . Meqenëse jemi këtu dhe ngulmoj gjithmonë ndoshta mund ta konsideroni që nuk është çështje e ditës por mendoj që është problem i madh që ka shoqëria jonë që ka të bëjë me largimin e njerëzve dhe meqenëse jemi tek arsimit sinqerisht jam ndjerë jashtëzakonisht shumë



keq që një mësues i imi për shkak të këtij sistemi për shkak të largimit të këtyre njerëzve u largua drejt Italisë. Dhe kemi të bëjmë me një njeri as më pak e as më shumë i quajtur Ilirjan Deda që rrjedh nga një familje në Rrogozhinë aq e nderuar që dy prindër për 4 dekada me radhë i kanë shërbyer këtij komuniteti. Dy arsimtarë të nderuar që për shkak të sistemit të këtij sistemi që askush nuk jep dot shpjegime që si ka mundësi që një njeri që ka 20 vite në arsim i disiplinuar dhe që vjen nga një famije që i ka dhënë vetëm arsim këtij qyteti është larguar me një vendim që as vetë ata që e kanë shkruar nuk arrijnë dot ta kuptojnë apo ta interpretojnë dhe që një shkollë që quhet shkolla në Sinaballaj “Zenun Isufi” këtë njeri që ishte aty në punë e zëvendëson dikush tjetër dhe largohet një njeri që ishte aty pa asnjë vërejtje pa asnjë lloj problemi.

Edison Memolla . Ç’lidhje ka këshilli.

Isa Halili . Jo nuk ka lidhje këshilli po flas jo nuk po tejkaloj fare...

Alime Hoxha . Nëse ka ankesa ai të drejtohet tek zyra arsimore...

Isa Halili . Kujt drejtori arsimore?

Alime Hoxha . Drejtorisë Arsimore të Rrogozhinës, nëse ka një gjë për ta sjellë le ta sjelli nuk ka asnjë dyshim për Ilirin as për sjellje as për...

Isa Halili . Po për çfarë arsye u largua?

Alime Hoxha . E di Iliri shumë mirë për çfarë është larguar.

Mitat Daja . Ta them unë këto ta merzisin punën që të ikësh vetë nuk përzejnë njeri.

Isa Halili . Si në kohën e komunizmit do t’i çojmë në Mlik.

Alime Hoxha . Edhe një gjë nuk e ka përzënë njeri, Iliri del në lëvizje paralele të detyruar se ngelet pa normë në atë shkollë i është çuar emri për të përzgjedhur një shkollë atje ku ka vende nuk është paraqitur. Atëherë si? Ku është këtu padrejtësia që i është bërë?

Isa Halili . Padrejtësia është këtu sepse një njeri që ka atë eksperiencë...

Alime Hoxha . Nuk jemi këtu për ta diskutuar bashkë e diskutuajmë... tani jemi në mbledhje këshilli.



Isa Halili . Meqë bëre pyetje të japë përgjigje.

Alime Hoxha . Jo nuk bëra pyetje fare.

Isa Halili . Po bëre se the ku është padrejtësia.

Alime Hoxha . Vazhdojmë me rendin e ditës.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me rendin e ditës. Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Gusht 2024.

Edison Memolla . Isa e ka motrën këtu.

Isa Halili . Po çfarë lidhje ka ...

Edison Memolla . Nuk është punë politike nuk është punë këshilli.

Mukades Gixhari . Kthehemi tek rendi i ditës të lutem, Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Gusht 2024. Njësia Kryevidh përfaqësohet nga z. Myslim Pjeçi.

Edison Memolla . Për arsye shëndetsore nuk është administratori por është përfaqësuesi.

Erind Tosku . Bëjeni shkresat ato kërkesa që keni ju dhe paraqitini në bashki se bëhet plani i buxhetit dhe duhen marrë në konsideratë, ky është një problem i hasur vazhdimisht në Kryevidh për mjetet e transportit. Do doja që të kishe dhe një relacion pak më të detajuar një formim më të saktë. E dyta për pjesën e bashkimit të shkollave nuk e di këni çuar shkresë drejtorisë së arsimit të bashkisë që të ja delegojë ZVA-së dhe ZVA të ja delegojë Ministrisë?

Edison Memolla . Ne si bashki problematik që kemi ngritur janë ujërat e zeza në gjithë zonën, energjia eletrike.

Indrit Dedej . Ka shumë problematikë dhe me ndriçimin e zonës.

Edison Memolla . Ndriçimi është sistemuar.



Myslim Pjeçi . Edhe diçka të fundit ato rezervuaret ne i shkelim në dimër me dhjetëra herë me çizme me fakte. Ai rezervuari i Domenit që për ju është një problem, e shkelim fillon shiu mbaron shiu dhe sjellim informacion për bashkinë e Rrogozhinës u rrit niveli sepse është me të vertetë alarmante. Ne shohim problematikat që kemi mundësi ne dhe i raportojmë të gjitha.

Mukades Gixhari . Nodnjë pyetje tjetër? Faleminderit për informacionin. Tani kemi administratorin e Njesisë Lekaj z. Deshir Gjumsi. Përshëndetje z. Deshir.

Edison Memolla . Të flas unë pak për njësinë Lekaj.

Indrit Dedej . Leje të flasë vetë.

Mitat Daja . Po filloi muhabeti atje të ikimi ne tjerët se nuk dëgjojmë as administratorin dhe askënd ose drejtoje taman ose na thuaj të ikim.

Mukades Gixhari . z. Indrit ja drejtove pyetjen.

Indrit Dedej . Çfarë ndihme ke pasur nga këto, a erdhën në kohë apo jo?

Edison Memolla . Zjarrfikësn kam qenë unë prezent, kanë qenë zjarrfikëset e Rrogozhinës, kanë qenë zjarrfikëset e Kavajës, zjarrfikëset e Peqinit e Lushnjes.

Erind Tosku . Një problematikë shumë e madhe është ndërprerja e energjisë elektrike e vazhdueshme probleme me linjat e amortizuara këto gjëra. Kjo mbase duke qenë se nuk është kompetenca juaj as e bashkisë por e rëndësishme është që ta delegojmë me shkresë sepse nga banorët nga bizneset ju takoheni i pari për këtë lloj problematike do donim që të bënit një relacion ose një shqetësim duke vënë në dijeni Bashkinë OSHE-në dhe drejtorinë e Rrogozhinës OSHE-në Durrës sepse është e nevojshme se ka pasur raste 9-orë pa drita në zonën e Lekajt dhe ky është shqetësim sepse personi që zgjohet në mëngjes për të bërë punë apo për të bërë diçka nuk ka drita për të çuar fëmijët në shkollë për t'i dhënë ushqim për ta larë nuk është gjë e vogël është problem i madh mendoj unë. Normalisht edhe gjëra të tjera duhen bërë ... shkojmë në shkollë s'ka ndriçim ska ngrohje do doja që nga drejtoria juaj ...

Enver Memolla . Pak më parë pata një komunikim të shkurtër me kryetarin e njësisë , urime për detyrën. Siç thashë dua një angazhim maksimal tuajin në bashkëpunim me drejtorinë e bujqësisë për sa i përket pronave që janë të mbjella me ullinj dhe për shkak të anulimit me ligjin e ri, janë akoma pa kontratë qeraje nga banorët. Nëse mund të bëjmë dëgjesa publike apo diçka e tillë



sepse edhe këto toka të kenë një kontratë ai banori të jetë i qetë për investimin që bën por edhe bashkia me anë të kontratës të përfitojë atë që mund të përfitojë dhe nga ato fonde të përfitohet dhe hapja e koridoreve për pyjet dhe hapja e rrugëve për të kaluar dhe për të shkuar tek ato toka këtu e kisha tek kjo pjesë. Duke parë dhe zonën e Lekajt që ka shumë ullishte tek kjo pjesë ka shumë banorë.

Mukades Gixhari . Të falendrojmë Deshir për punët e mira që ke bërë suksese në të ardhmen. Ftoj administratorin e njësisë Gosë z. Denis Sako.

Denis Sako . Përshëndetje të gjithëve! Me shumicën këtu njihem për ata që nuk njihem unë jam Denisi administratori i Njësisë Gosë.

Silvana Aliu . Vazhdo me çfarë ke bërë.

Denis Sako . Nga periudha Qershor-Gusht 2024 Njësia Administrative Gosë ka bërë disa punë të mira në bashkëpunim edhe me bashkinë edhe privatisht , kështu që dhe mbarëvajtja në punë me ato burime njerëzore që ne kemi pasur. Mbarëvatja në varreza kanalet kulluese deri diku është punuar në mënyrë sistematike dhe nga ana e administratës për t'i mbaruar punë qytetarëve në çdo moment .

Edison Memolla . Problematikë është energjia elektrike që e përmendëm dhe pjesa e plazhit është një plazh i ri që është hapur është pjesa e rrugës që shpresojmë ta realizojmë vitin e ardhshëm është një gjë që është bërë gangrenë.

Denis Sako . Ky shqetësim ka 35 vjet dhe tani hajde se e konstatuam ne sot ...

Erind Tosku . Ta shpjegoj ndryshimin në 30 vjet letrat humbnin rrugës, tani je online, je i digjitalizuar ke struktura të tjera që ti mund të përdorësh mund të çosh letrat mund të komunikosh shumë herë më shpejt më çfarëdo lloj institucioni edhe të bësh një kërkesë nga këshilli bashkiak të vijë drejtori i OSHE-së. Edhe ti si administrator , unë nuk e thërras si këshilltar se po nuk më erdhi ankesa ty si administrator, siç i thashë dhe administratorit të Lekajt në qoftë në qoftë se një problem nuk e delegoni rri jetim ...

Silvana Aliu . Kjo puna e administratorëve qytetari vinka tek kryetari i bashkisë dhe këto nuk qenkan në dijeni fare se çfarë bëhet... lëre njëherë të lirë të flasi vetë. Një muaj rresht në Gusht nga ora 6 deri në 10 unë kam qenë në Vilë Bashtovë nuk kam parë asnjë punëtor, ndoshta i sillni pasdite.



Denis Sako . Jo me jo se nuk punojmë mes të natës.

Silvana Aliu . Po flas në mënyrë serioze nuk kam parë punëtro.

Denis Sako . Tani unë mendoj që 5 veta këto janë burimet njerëzore nuk kanë pasur mjete edhe të vazhdojnë rrugën që ti ke bërë që janë prerë ferrat edhe të gjitha deri sa ke shkuar ti në breg të detit atë kush e ka bërë, unë e kam bërë apo ato punëtorët sezonalë?

Silvana Aliu . Në mes të Gushtit kur është turizmi ti të jesh duke prerë ferra, ti vetëm tek rruga nuk shkoni në bregdet?

Denis Sako . Po edhe në bregdet varet ku e ke bërë plazhin ... në grykëderdhje të Shkumbinit.

Silvana Aliu . Ku derdhet Shkumbini shkoj.

Denis Sako . Atje nuk kam çfarë bëj, atje nuk t'i sjell dot.

Mitat Daja . Denis kam një pyetje për rrugën e Vilë Bashtovës dhe faktikisht është ngritur disa herë dua të bëj një pyetje shumë konkrete rruga e Vilë Bashtovës është fond i Bashkisë apo fond kombëtar? Ajo rruga kryesore aty ku u bë dhe gjetë rahmet aksidenti, ajo është rrugë e rrezikshme, është menduar ndonjëherë që ajo të bëhet ...?

Edison Memolla . Kam çuar unë kërkesë tek kthesa e fortë për të vënë mbrojtëse.

Mitat Daja . Sepse është gjynah aty kanë ndodhur shumë herë aksidente dhe kemi pasur me pasojë dhe vdekjen.

Edison Memolla . Ajo është rrugë me administrim nga ARRSH-ja.

Mitat Daja . A është e mundur që t'i bëhen mburoja asaj pjese që të mos bëhet burim aksidenti?

Denis Sako . Derisa nuk është kompetencë e jona është e ARRSH-së, si mund ta bëjmë ne?

Mitat Daja . I keni bërë kërkesë ARRSH-së?

Edison Memolla . I kemi bërë kam qenë në takim.



Isa Halili . Meqenëse kemi këtu kryetarin e njësisë administrative Gosë, doja të dija se sa ka qenë ke një numër se sa është vizituar po themi konkretisht “Kalaja e Bashtovës” në sezoni veror që lam pas?

Denis Sako . Jo nuk e kam.

Isa Halili . Po në shifra prodhuar në aspektin ekonomik, çfarë të ardhurash i ka sjellë vija bregdetare e Bashtovës njësisë administrative që mbuloni sot? Për taksat e bizneseve dhe jo vetëm ky sezon veror që ne lam pas, ka një shifër konkrete të ardhurash që ka fituar kjo njësi administrative për shkak të turizmit?

Denis Sako . Tani kur të bësh mbledhjen tjetër unë nuk kam nevojë as të ma sjellësh me shkrim as si po ma bën pyejtne me gojë sepse unë nuk jam specialist i taksave, kur të bësh herës tjetër të vi ta marr...

Isa Halili . Presupozohej që është një informacion që duhet ta dini ju si kreu i asaj njësie administrative sepse me ata njerëz që janë atje që kanë lidhje me ekonominë dhe jo vetëm, pra ju bashkëpunoni përditë apo jo? Tani në qoftë se ju thoni që ju thoni që nuk keni informacion në lidhje me këtë gjë unë nuk e di se kush mund të ketë tjetër.

Denis Sako . Tani ngrihu dhe më thuaj mua një gjë nga ligjet por unë nuk jam jurist.

Isa Halili . Jo nuk ka lidhje me ligjet.

Silvana Aliu . Nëse ti ke sjellë një informacion sot duhet ta kishe dhe atë që përmendet.

Isa Halili . Se ju në narrativën tuaj të komunikimit, ju thatë që turizmi dhe njerëzit që janë shtuar në njësinë administrative unë thjeshtë pyeta në lidhje me këtë gjë? Flasim për një sezon që është mbyllur ka muaj.

Marsida Thartori . Është bërë raportimi i të ardhurave mbledhjen e shkuar.

Isa Halili . Është bërë raportimi nga drejtorja e taksave dhe kryetarit nuk i është dhënë ky informacion?

Marsida Thartori . Jo, sepse specialistët e taksave nuk varen nga njësitë administrative por varen nga drejtorja e taksave.



Isa Halili . Pikërisht pra drejtoria e taksave çon informacion në lidhje me ...

Marsida Thartori . Dhe kontratat lidhen në bashki nga kryetari nuk lidhen nga njësia administrative.

Isa Halili . Pikërisht pra, por nuk ka një marrëdhënie bilaterale mes dy institucioneve?

Marsida Thartori . Të ardhurat administrohen nga bashkia nuk administrohen nga njësia.

Isa Halili . Nuk ka lidhje nuk administrohen nga njësia, mua nuk më intereson se si këto të ardhura janë menaxhuar. Unë doja të dija thjeshtë shifrën sepse kryetari ka të bëjë me njësinë administrative të vetën të atij.

Enver Memolla . A ka një plan për shtrimin e pjesës së rrugës së pashtruar që të çon në Vilë?

Edison Memolla . Ka dy plane njëri që vitin e ardhshëm ta fusim në buxhetin e bashkisë , tjetri është plan që i kemi çuar kërkesa ministrive përkatëse.

Erind Tosku . Kush është qasja që mund të bëhet më kollaj?

Edison Memolla . Vitin e ardhshëm qasja është që ajo duhet do bëhet.

Mukades Gixhari . Faleminderit Denisi për informacionin suksese ju urojmë në të ardhmen. Kalojmë tek të ndryshmet.

Isa Halili . Po kryetari i njësisë administrative Sinaballaj nuk është?

Mukades Gixhari . Atëherë Njësia Sinaballaj për arsye familjare nuk ka ardhur dhe ne do ta shtyjmë për herën tjetër mbledhjen e radhës.

Mitat Daja . Ai gjithmonë arsye familjare ka pasur.

Isa Halili . Dua të di thjeshtë meqë jemi këtu që mos ta lejmë mbrapa se unë atë njësi të paktën përfaqësoj, doja të dija kur do vijë ky zotëria për këto gjëra.

Mukades Gixhari . Do vijë në mbledhjen e radhës. Vazhdojmë me pikën 16, Të ndryshme. Shqyrtim i kërkesës së qytetarit z. Fahri Rexhepi për trajtimin dhe strehimin e qenve endacakë.



Unë do ta lexoj kërkesën e zotërisë : Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për trajtimin e qenve të abandonuar dhe strehimin e tyre si shumë bashki të tjera. Me respekt z.Fahri Rexhepi. z. Rezart.

Enver Memolla . Kryetare më fal, para se ta nisi Rezarti kam një pyetje të drejtpërdrejtë. Mesa mbaj mend unë kjo kërkesë ka ardhur njëherë në këshill?

Mukades Gixhari . Po.

Mitat Daja . E vërteta është që qentë janë bërë problematikë në qytet ne e kemi diskutuar dhe herë tjetër, zgjidhja nuk e di çfarë lloj zgjidhjeje mund të japë bashkia po një zgjidhje duhet...

Edison Memolla . Një zgjidhje ne ja kemi dhënë Fahriut por nuk ka Bashkia fondet e duhura që t'i mbajë muaj për muaj...

Mitat Daja . Po të gjehet një mundësi...

Fahri Rexhepi . Tani nuk kemi shumë problem për qentë se nuk na hanë më ato i hamë ne ata, se po na i helmojnë përditë, pardje helmuan tre, një ditë para helmuan dy të tjerë. Kanë helmuar pesë gjithsej janë 37 (tridhjetë e shtatë) qenë të helmuar në Rrogozhinë.

Edison Memolla . I ke konstatuar?

Fahri Rexhepi . I kam të filmuar.

Demir Xhafa (veterineri i bashkisë) . Janë të ngordhur ndër vite 37 nuk kanë ngordhur sot për nesër.

Fahri Rexhepi . Para tre ditësh nuk zgjat më tepër se 20 minuta ngordhja e qenit.

Mukades Gixhari . Të dëgjojmë pak drejtorin e financës z. Fahri të na relatojë në lidhje me kërkesën tuaj.

Fahri Rexhepi . Ai është i fundit kur paguan paratë për të blerë një mall një gjë... janë të tjera probleme përpara kur unë të mbaroj le të flasë ai. Në radhë të parë desha të ju falenderoj si këshill bashkiak që jeni mbledhur këtu për të na zgjidhur problemet e komunitetit. Megjithëse nuk keni bërë asgjë... Jeni shumë të nderuar sidomos kjo zonja këtu, ndoshta kjo është ambientuar në Gosë...



Edison Memolla . Do vazhdosh të thuash...

Fahri Rexhepi . Po për këtë problem e kam ajo bën procedurat.

Edison Memolla . Nuk bën procedura asnjë.

Fahri Rexhepi . Po kush i bën?

Edison Memolla . Nuk të japim llogari ty kush i bën por vazhdo thuaj kërkesën.

Mukades Gixhari . Z. Fahri do tregoni problemin që keni ardhur pak shkurt dhe saktë të lutem.

Fahri Rexhepi . E di zonjë e di dhe vetë se për çfarë vi unë nuk vi për problemet e mia as të familjes time, vi për problemet që i shkaktohen komunitetit nga qentë endacakë të abandonuar që bashkia është e detyruar t'i shërbejë atyre. Ka vite që thuhet, ky tani ka ardhur , vite që thuhet që do bëhet një strehëz. Kur toka të lira keni, kur kanë bërë njësitë administrative nga 3,4,5 mijë banorë kanë bërë strehëz. Ka bërë Sukthi, ka bërë Fllaka, ka bërë Sektori i Ri ka bërë Cerriku...

Demir Xhafa . Cerriku nuk ka bërë.

Fahri Rexhepi . Ne jemi një Bashki me 40 e kusur mijë banorë nuk bëjmë një strehëz. Këtu në Rrogozhinë për sa i përket qendrës mos dalim në periferi janë tek 60-70 copë qen, nëse dalim tek ura ose lart në fshat mund të shkojë dhe më shumë. 40 copë a më shumë janë në Gosë që nuk kanë marrë asnjë lloj shërbimi. Edhe kur të marr një thes dy apo dhjetë do më vijë kjo këtu mbrapa (tregon me gisht gojën) dhe më japin atëherë kur unë kam hyrë në borxh edhe shkoi i jap edhe ngel prap pa gjë. Asnjë lloj medikamenti për sëmundje është e vërtetë? Më keni dhënë në Prill 960 mijë lekë ushqim .

Edison Memolla . Tani kërkesa jote këtu në Këshill kush është?

Enver Memolla . Nuk është çështje për t'u anashkaluar, janë disa gjëra që janë faktorë të ndryshëm, që nga miratimi i projektbuxhetit të Bashkisë nëse ka një plan B, zyra e bujqësisë e kap në se ka një plan për qendër sociale (strehëz) nëse ka qenë apo jo. E dyta duhet të dimë zotëria është në emër të shoqatës së lincësuar apo jo, apo është thjeshtë humanitar në atë pjesë. Sepse realisht ne kur miratojmë fondin ka një numër llogarie, kur çohet fondi mbahet tatim fitimi dhe për çfarë do e çosh fondin, tani t'i bëjmë këto gjëra në të zezë unë se bëj dot. Sepse këtu do



dali veterineri apo kush është zyra përkatëse thotë unë kam në plan për të bërë qendrën për strehimin e qenve endacakë dhe këtu nis historia.

Indrit Dedej . Jo nuk merret vendimi që kanë në plan s'kanë në plan është e detyrueshme sepse qentë ai është i tërbuar vdes fëmijën e huaj.

Enver Memolla . Unë këtë po bëj kjo kërkesë e ka këtë përgjigje ?

Isa Halili . Ajo nuk është marrë në konsideratë.

Enver Memolla . Nuk është marrë në konsideratë në mendimin tim në opinion tim e thashë dhe herën që kaloi kjo konsideratë bëhet kur fillon e diskutohet paketa fiskale dhe buxheti i ri për vitin tjetër. Ne këtu kemi të ardhura aktualisht kemi prona apo toka mund ta bëjë këtë pjesë si bashkia nga ana e vet mund të shtojë punonjës të tillë, si zotëria që është këtu vullnetar. Se janë gjëra që këto flasin nga precedentët që ndodhin, këtu zyrat nuk po thonë që ne kemi në plan të këtij buxheti 2024 për ta bërë këtë qendër. Kanë lekë për të marrë godinë me qera punë e tyre por realisht duhet kthyer një përgjigje zyrtare si funksionon kjo pjesë. Edhe zotëria mos lodhet lart e poshtë në këshill bashkiak edhe ne të jemi më të qetë, sepse thashë e kam kritikë shumë herë nuk duhet të vijne kërkesa të tilla në këshill bashkiak kur nuk ka fond bashkia apo kur nuk ka projekt. Sepse përplasat këshilli bashkiak me personat.

Isa Halili . Nuk pranojmë gjë nëse nuk ka.

Enver Memolla . Unë si këshill bashkiak çfarë do i them këtij zotërisë?

Indrit Dedej . Plotëso atë që lejon ligji.

Erind Tosku . I kthen përgjigje funksionari i bashkisë.

Enver Memolla . Në bazë të kësaj kërkesë zyra përkatëse thotë zotëri Fahri Rexhepi, në bazë të kërkesës tuaj në buxhetin e miratuar për vitin 2024 nuk ka fonde për ndërtimin e strehëzës. Dhe nuk vjen këtu të përplasem me ty kot, sepse do mësojë si puna e atij u dogjën 3 mijë dengje por sa ishin nuk pashë gjë. Atëherë ta zgjidhim mos sill njerz në këshill kot, unë këtë po them.

Isa Halili . Mer kohë kot kur ne nuk i japim do zgjidhje.

Enver Memolla . S'kam çfarë them unë për këtë pjesë çfarë do miratoj.



Edison Memolla . Bashkia që të shkojë në lëvrim fondi duhet të ketë projekt duhet të ketë, në bazë të projektit bëhet financimi. Duhet financimi me buxhetin që kemi me të ardhurat që kemi ne nuk mund ... sepse do bësh qendrën do fusësh punëtorë do i mbash me ushqim me vaksinim do një buxhet të caktuar.

Isa Halili . Unë mendoj që lajmi i mirë që mund t'i japim zotërisë sot meqenëse jemi në këto kushte është që në projektbuxhetin e vitit tjetër të merret në konsideratë kjo lloj gjëje. Edhe ajo që thotë Veri mbase nuk e kuptuat është kjo çështje pra nuk duhet të vijë këto lloj problematikash edhe pse janë të qenësishme për komunitetin kur ne nuk jemi as të japim zgjidhje sepse nuk kemi kushte për ta bërë një gjë të tillë. Pikërisht ne këtë gjë do ta marrim në konsideratë...

Indrit Dedej . E ke koncept të gabuar, qytetari do vijë të bëjë kërkesë dhe në këshill bashkiak...

Isa Halili . Po nuk po e ndaloj unë .

Enver Memolla . Ky rast është hera e dytë që vjen.

Isa Halili . Pse nuk doni të kuptoni atë që jam duke thënë, zotëria në fjalë është një problem shumë i rëndësishëm edhe shumë mirë. E drejta e personit në fjalë është legjitime dhe duhet marrë në konsideratë por këto lloj të drejtash si kjo arsye dhe shumë gjëra të tjera nuk mund të vijë në rend dite kur ne nuk kemi informacion dhe nuk kemi kushte është fare e thjeshtë.

Erind Tosku . Ne diskutuam për këtë pjesë e rëndësishme është që qytetari të marrë që aktualisht bashkia mesa kuptova nuk ka fond për të krijuar një vendstrehim.

Fahri Rexhepi . Pse nuk ka fond? Kur ka një njësi administrative me 3,4,5 mijë banorë nuk kemi ne me 40 mijë banorë me të ardhura më të shumta.

Erind Tosku . Nuk di unë sa lekë ka bashkia, unë po them mesa kuptova me bisedimin dhe analizën time. Edhe tjetër është me vend ajo që tha Veri, Isai dhe Indriti që në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm të futet në pikë të planifikimit si të krijojmë dhe menaxhimin e këtyre qenve endacakë për trajtimin me anë mjekësore ushqimin edhe...

Isa Halili . Problemi është që gjatë kësaj periudhe këto qen që po helmohen çfarë do bëhet?

Erind Tosku . Se di çfarë të them Isa.



Isa Halili . Sepse ky është shqetësimi më i madh i zotërisë.

Erind Tosku . Kërkesa ka ardhur për këtë gjë me Isa.

Isa Halili . Jo kjo është një gjë që pret e kuptova shumë mirë, jam shumë dakord por puna është se ai po thoshte janë helmuar gjatë kësaj periudhe.

Erind Tosku . Nuk është vetëm bashkia jonë që ka qenë endacakë edhe po i trajtojnë të gjithë. Ne po mundohemi t'i japim një zgjidhje.

Fahri Rexhepi . Kam ardhur kam denoncuar që po shtien helme që janë të ndaluar me ligj, ka vajtur kush i ka kontrolluar?

Elton Xhani . Ka dal mbrojtja e konsumatorit me veterinerin në terren.

Erind Tosku . Dëgjo se do marësh përgjigjen që besoj do jetë pozitive.

Rezart Vogli . Po i parashtroja dhe anëtarëve të këshillit bashkiak, atë projektin që e ke dhuratë nga Hollanda apo nga ndonjë shoqatë e dorëzohet në bashki të Rrogozhinës bashkë me kërkesën...

Edison Memolla . Me një plan biznesi se sa shkon gjatë gjithë vitit kostoja.

Fahri Rexhepi . Ta them unë...

Edison Memolla . Dëgjoji këto që po thotë kur t'i plotësosh.

Rezart Vogli . Këtu do vijë së shpejti dhe drejtorja e financës bashkë me drejtorinë e taksave për të diskutuar paketën fiskale dhe projektbuxhetin e vitit pasardhës. Një ndër pikat të jetë dhe diskutimi për strehëzën të qenve endacakë të qytetit të Rrogozhinës që dhe ne të dimë konkretisht se çfarë do kërkojmë për vitin tjetër dhe këshilltarët të dinë se për çfarë kostoje bëhet fjalë e gjithë gjëja.

Edison Memolla . Atëherë Bashkia funksionon me rregulla me ligje, dëshira është përtej por është me mundësi. Ti si jeton ke shtëpi vilë të madhe jo kë një apartament siç kemi të gjithë.

Silvana Aliu . Atëherë unë do jap mendimin tim për aq sa jam në dijeni nuk e di ... Bashkia në



këto raste të tilla siç je ti vullnetar dhe unë kam qenë studente dikur është bashkëpunëtor një pjesë mund të jetë 20-30 % pjesën tjetër e ka një shoqatë por 100 % bashkia .

Mitat Daja . Atëherë duhet një shoqatë e licensuar të drejtojë një kërkesë siç e tha dhe Veri dhe kështu mund të funksionojë.

Fahri Rexhepi . Shoqatat janë jofitimprurëse, mbahen me donacione.

Mitat Daja . Pikërisht pra kërkon nga bashkia një donacion.

Rezart Vogli . Fahri e lejme kështu nesër këshilltari punonjësi i bashkisë të dorëzojë atë projektin që i keni dorëzuar ju, ta marrim në shqyrtim për ditët pasardhëse për projektbuxhetin e vitit pasardhës që ta dimë mesa shkon kostoja a e mbulojmë dot sa mundësi kemi të mbulojmë, mund t'i drejtohem dikujt tjetër për këto bashkëfinancime. Atëherë këshilltarët janë të gjithë dakord që kur të vijmë për të diskutuar projektbuxhetin të vijë dhe kërkesa për një qendër sociale.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me kërkesën tjetër. z. Fahri je i qartë? Ne jemi dakordësuar për të mirë.

Edison Memolla . Sa shkon kostoja sill koston sa shkon mbajtja e një qeni për një vit, sa qen do jenë?

Mukades Gixhari . Fakeminderit z. Fahri, ke gjithë mirëkuptimin tonë të lutem na lejo që ne të vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Fahri Rexhepi . Të dal jashtë?

Mukades Gixhari . Jo absolutisht jo, mund të qëndrosh. Shqyrtim i kërkesës së qytetarit z. Haziz Kashari për ndihmë financiare për rikuperimin e dëmit të kafshëve të ngordhura.

Demir Xhafa . Është një fermer që ka një kompleks lopësh në datë 3 Shtator i kanë ngordhur 2 lopë ka njoftuar shërbimin veterinar. Dhe diagnoza e shërbimit veterinar është se janë helmuar nga ushqimi është helmim akut dhe nuk është sëmundje që subvencionohet nga shteti sepse nuk është tuberkuloz, plasje, brucelozë por thjeshtë kërkon një ndihmë financiare nga ana e këshillit bashkiak jo se është e detyrueshme por në formë përkrahje. Janë dy lopë të ngordhura të racës holstein.



Enver Memolla . Kryetare ky është rasti i 3 apo 4 për ngordhje lopësh unë e njoh personin marr shkas dhe nga përgjigja e vetrinerit që nuk e përcakton ligji . Kërkohej që këshilli bashkiak të japë një ndihmë sociale. Të vijë si projektvendim kur diagnoza juaj nuk lejon pse ma sjell kërkesë ma sill projektvendim 30, 40, 50 mijë sa e ka këshilli dhe këtu e mbyllim. Sille si projektvendim e kalojmë se kalojmë mos e sill si kërkesë kot .

Indrit Dedej . Ta bëjë gati herë tjetër e ta sjelli.

Isa Halili . Jo duhet ta kishte bërë një gjë të tillë.

Mitat Daja . Pra thotë sillni një projektvendim me kërkesë të qartë të kalojmë projektvendimin.

Edison Memolla . Jeni dakord që të futet projektvendim?

Mukades Gixhari . Mbledhjen e radhës të vijë projektvendimi.

Enver Memolla . Për mbledhjen e radhës propozoj meqë është dëm i madh për fermerin të kalojë shuma maksimale që lejon ligji.

Mukades Gixhari . Tek të tjera kemi dhe një kërkesë.

Enver Memolla . Për muajin Shtator në planin e punës të këshillit bashkiak është shqyrtimi për Projektbuxhetin afatmesëm PBA-ja. Pse nuk ka ardhur në Këshill Bashkiak? Kjo është puna jonë nga Marsi që ka filluar aplikimi i naftës kur ishte 1 mijë lekë tarifa për të marrë një vërtetim punonjësit e bashkisë Rrogozhinë i sillnin njerëzit tek këshilli, i kaloi këshilli bashkiak. Dhe jo më shumë se para 2-3 ditësh kam qenë në një zyrë ku persona që kanë humbur mallin e tyre i thanë drejtohuni me shkresë këshillit bashkiak. Çfarë ka në dorë këshilli bashkiak? Ta kuptojnë banorët jashtë ne nuk miratojmë kërkesa ne miratojmë projektvendimet që sjell bashkia Rrogozhinë dhe unë them që kjo sagë duhet të marrë fund.

Edison Memolla . Dhe kërkesat duhet të merren në shqyrtim.

Enver Memolla . Shqyrtimi merret, nëse ke një ligj në tavolinë që ta lejon sille projektvendimin në këshill pastaj këshilli e miraton po ose jo me fondet që ke ti. Por mund të jetë kërkesa mbrapa projektvendimi, e miratojmë po ose jo. Dhe tani vijmë këtu ne e dimë nga veterineri që zotëria nuk e përfitonte hajde ta diskutojmë për çfarë ta diskutojmë pse ngordhën ato ngordhën mbaruan punë. A ka gjë për atë apo nuk ka gjë për atë.



Edison Mmolla . Atëherë sugjerimi juaj është çdo kërkesë që mund të ketë bazë ligjore të vijë direkt në projektvendim?

Enver Memolla . Po.

Isa Halili . Po se vonohemi kot me gjëra që ...

Edison Memolla . Po tani jemi ok .

Enver Memolla . Shmang dhe kotraditën.

Edison Memolla . Tani dhe nga sekretari i këshillit.

Ervis Shera . Kërkesat vijnë dhe i drejtohen këshillit bashkiak, ciklohen nga nënkryetari me të drejtë ai ja sjell këshillit, unë e marr dhe nuk kam tagër as ta heq as të ja përcjell drejtorive dhe asgjë, unë e sjell në këshill. Këshilli jep pëlqimin do ta miratojë në rastin e kërkesës së Hazizit të vijë në formë projektvendimi ok siç ju la porosi, në qoftë se ju nuk do ishit dakord nuk do jepnit pëlqimin e rrëzoni si kërkesë. Kjo është një formë, pastaj nëse thua që kjo na merr shumë kohë në Këshill mund të bëjmë diçka tjetër që Kryesia e Këshillit i fut ose i nxjerr por unë nuk kam tagër, unë i përcjell. Kjo ndodh edhe ngaqë nuk jaë mbledhur komisionet.

Enver Memolla . Atë po them unë që në qoftë se del komisioni të relatojë ka mbaruar mbledhja.

Mukades Gixhari . Kemi dhe një kërkesë tjetër që na erdhi tani pa filluar mbledhja në momentet e fundit. Është një kërkesë e drejtuar komisionit të posaçëm të rindërtimit, për dijeni Kryetarit të Bashkisë për dijeni Këshillit Bashkiak. Të nderuar anëtarë të komisionit të posaçëm për rindërtim duke marrë shkas nga problematikat e mëspostëme si 17 familje të bashkisë Rrogozhinë dhe pse e kanë përfituar statusin për rindërtim kanë mbetur pezull dhe nuk është bërë asnjë disbursim i qerasë as mujore dhe as disbursim i fondeve për rindërtim. Është bërë nga këshilltari z. Mitat Daja.

Indrit Dedej . Nuk e ka kompetencë këshilli.

Mukades Gixhari . Pika 2 është e qartë që ka një abuzim me listat e përfituesve nga fondet e tërmetit dhe për këtë arsye kërkoj të më vihet në dispozicion listat më të gjithë përfituesit e fondeve që të kem akses të kësaj liste. Në cilësinë e anëtarit të pavarur të këshillit bashkiak z. Mitat Daja.



Mukades Gixhari . Ato 17 familje z. Rezart thatë që ishin 25?

Rezart Vogli . Z. Mitat i referohet familjeve që janë të papërfunduara nga fondi shqiptar i zhvillimit.

Mitat Daja . Mund ta sjellësh me shkrim informacionin.

Edison Memolla . Do ta sjellim informacionin me shkrim.

Sokol Gosa . Kryetare një gjë kisha. Tani problematikë në qytetin tonë është pastrimi ka disa ditë që nuk është bërë dhe kjo është shqetësuese. Edhe Fahriu jo vetëm Fahriu por edhe ne si qytetarë kemi problem këto qentë nuk e dimë çfarë do bëjmë, ai nuk është më i pranishëm por është tepër tepër shqetësuese është emergjencë mendoj unë koha nuk pret dakord me ato që ju thatë, jo projekte e gjëra por zgjidhje është pa na ndodhur ndonjë katastrofë me qentë që të na hajjë njerëz fëmijë larg qoftë e të gjitha me radhë. Edhe pastrimi veni në dijeni firmën kush e ka.

Edison Memolla . Është e vërtetë është krijuar një ngërç aty dhe po merremi me bazat ligjore çfarë na lejon ligji kurse për pjesën e qenve jemi dakord.

Sokol Gosa . Po por duhet një zgjidhje se s'bën.

Indrit Dedej . Problem është dhe në Durrës kjo puna e qenve dhe në Tiranë.

Sokol Gosa . Kisha dhe diçka tjetër meqë fusha e sportit e dinë vlerat e arritjet që ka pasur ekipi jonë "Egnatia" edhe propozoj që presidentit të ekipit z. Agim Demrozi t'i akordojmë titullin "Qytetar Nderi" i Rrogozhinës.

Indrit Dedej . Të ja japim Xhelalit njëherë se është shkrimtar.

Sokol Gosa . Dhe nuk ka problem le të çohen le të ikin. Dhe prap po në kuadrin e sportit jemi në kuadrin e 90-vjetorit të "Egnatias" dhe të mendojmë çfarë mund të organizojmë është diçka madhështore si këshill çfarë të vendosim për të bërë një organizim një festë atë ditë sepse stadiumi është duke mbaruar, me ndriçim me të gjitha do të jetë me të vërtetë... në Nëntor besoj.

Isa Halili . Mbase jo se jemi dy njerëz se Egnatia është e të gjithëve aq më tepër profesori që ka kontribuar po flasim për një ish futbollist kapiten që për hir të vërtetës meriton t'i dëgjohet fjala. Tani unë e kam thënë dhe herë të tjera e po e them prap në këtë vend që quhet bashkia



Rrogozhinës nëse ka ndonjë gjë që jo vetëm Rrogozhinasit vetë por edhe shqiptarët që na ngrejnë kapelen është pikërisht futboli. Dhe nuk ka ardhur si produkt as i joni dhe ne kemi meritën tonë sigurisht kur themi ne flasim vendi këtu se pa jemi ne që janë ata. E megjithatë është një punë kolosale e bërë nga një njeri që ka menaxhuar në këtë mënyrë nuk po flasim për ti thënë lavde nuk jam unë askushi as profesori askush asneji tjetër por janë shifrat faktet që ndoshta edhe vetë kryetari ka luajtur për atë fanellë ka djersitur dhe besoj ai por dhe ne tjerët por kush ka luajtur me Egnatian se ka menduar në subkoshiençën e vet që një ditë Egnatia do shpallej kampione e Republikës së Shqipërisë dhe besoj që meriton respekt sa herë flasim për këtë lloj gjëje e para. E dyta unë nuk e di se ç'është bërë në lidhje me stadiumin nuk është projekt se ka një keqkuptim se vjen nga mospasja e informacionit...

Silvana Aliu . Nëse do vijmë të gjithë të punojmë tek stadiumi do kemi informacione më të sigurta, kështu që mos na bëni kaq servilizëm se është muaji i katërt dhe kryetari na dha fjalën e vënies në dispozicion të kontratës. Çfarë fitojmë ne si bashki? 25% i bashkisë ku është? Se po e nxirrni Demrozin se kush është, e ka privat o zotëri! Më thuaj një vepër bamirësie që zotëria ka bërë? I pretë pemët e qytetit natën për gjithë natën e sot kësaj dite akoma nuk i keni pastruar. Dakord? Po për çfarë po e ngre atë në pedestal, çfarë ka bërë?

Isa Halili . Ato që thashë unë nëse ke ndonjë kundër argument ti ma thuaj ta dëgjoj. Të më flasësh ti mua për servilizëm, nëse ke një argument që personi në fjalë mua apo personin tjetër që foli këtu ka dhënë një qindarkë në lidhje me servilizmin dhe jo vetëm ka njerëz që na dëgjojnë jetojmë në një komunitet shumë të vogël ku ne i dimë shumë mirë. Unë kam ushtruar profesionin tim i paguar nga një tjetër gjë nuk ka lidhje me Agim Demrozin. Po pra por duhet të kërkosh ndjesë njëherë për atë ... servilizimin tërhiqe mbrapa thuaj ndonjë gjë tjetër.

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak...

Isa Halili . Jo jo nuk e dëgjoj fare zyshen unë se pse zysha para se të flasi të kërkojë ndjesë për ato fjalë që tha.

Silvana Aliu . Edhe së dyti...

Isa Halili . Vazhdo tek së pari njëherë servilizmin tërhiqe mbrapsht dhe thuaj kërkuj ndjesë... Është fyerje totale dinjiteti të më flasësh mua për servilizëm, unë quhem Isa Halili. Nëse ke ti një fakt apo ndokush që unë kam një qindarkë nga Agim Demrozi për një gjë që kam bërë dhe të thuash servil është turp, është turp.



Mukades Gixhari . Po znoj. Silvana.

Isa Halili . Jo të kërkojë ndjesë përpara se nuk e lejoj të flasi, se ndoshta mund ta quaj gjë të vogël ku e di më çfarë ... të mëthuash servil nuk e pranoj kurrësi dhe në qoftë se zysha gjen një si vetja që e ka këtë lloj mendimi unë e lë këtë bisedë. Servilizmin zysha ta gjejë të ja thotë atij që e ka.

Edison Memolla . Moderoheni komunikimin.

Isa Halili . Jo është shumë i moderuar se mund të kisha reaguuar në mënyra të tjera por realisht të më thuash servil se pranoj kurrë, se nuk kam qenë asnjë sekondë në jetën time.

Mitat Daja . O zysh kur të mbarojë Vana kam unë një fjalë.

Silvana Aliu . Kam kërkuar dhe nga drejtoresha juridike 2 kontrata për vënie në dispozicion.

Edison Memolla . I ke gati.

Mukades Gixhari . I ke kërkuar me shkrim drejtorive përkatëse.

Silvana Aliu . Të shohim çfarë fitojmë ne nga ky 25 % dhe ta dimë fitojnë punëtorët ...

Isa Halili . E di ku është problemi më i madh këtu, kur ne flasim me njëri tjetrin ne e kemi personale më shumë se sa . Kur ne po diskutojmë profesori i nderuar tha një gjë tjetër , jo me të largohet kush të dojë nuk është problem fare. Tani problemi ku është kërkesa e profesorit me 25 % janë dy gjëra krejtësisht ndryshe nga njëra tjetra. Nga kërkesa e profesorit ta kthesh në personale...

Silvana Aliu . Nëse ti në grupin e këshilltarëve në whatsapp e ke që të bëhen kur ne flasim për gjëra të ndryshme të bëhen screenshot dhe të ja çojnë X-it apo Y-it po them që nuk më bie mendja fare se mund të ja çoni kujt të doni. Që të vijë personi tek dera dhe të më thotë ti dje ke bërë këtë këtë, mua nuk më bëhet vonë personalisht...

Isa Halili . Kush ?

Silvana Aliu . Unë nuk po flas me emra...



Isa Halili . Po flas unë të lutem ti atë që ke thuaje.

Silvana Aliu . Nëse e ke grupin e whatsapp për gjëra të tilla e mbyllim, dakord?

Mukades Gixhari . Absolutisht, jemi vetëm ne këshilltarët që diskutojmë problemet tona.

Isa Halili . Së pari me këtë që po thoshte profesori me këtë që po thotë zysha ka shumë të drejtë dhe meriton vëmendjen e vet. Këtë që po thoshte profesori dhe arritja tek servilizmi janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme.

Silvana Aliu . A ke një konflikt interesi mer burr i dheut se na lodhët se dhe unë aty ku do haj do flas.

Isa Halili . Kush ka konflikt interesi unë që po flas?

Silvana Aliu . Zotëria në fjalë e dinte që ishte bërë fondi për buxhetin e ardhshëm 120 milion kur nuk e dimë ne.

Isa Halili . Ore unë quhem Isa Halili po flisja unë të lutem tani.

Enver Memolla . Unë nuk dua të përshihem fare në këtë debat, propozimi qëndron i anëtarit të këshillit që është aty por unë kam një gjë tjetër që është pak më rëndësishme për mbarëvajtjen e tremujorit në vazhdim. Kemi tre muaj punë me paketën fiskale, kryetarja e këshillit ka thënë që mbledhjen e kaluar që paketa fiskale duhet të jetë në diskutim para. Që të mos mësojmë atë që kaluam vitin e kaluar kjo është më e mira për të gjithë punët e bashkisë.

Edison Memolla . Duhet të fillojmë të bëjmë dëgjesa publike në çdo njësi administrative, nëse keni propozime fillojmë.

Enver Memolla . Kryetare jeni jashtë planit në Shtator duhet të kishte ardhur në Tetor e dua patjetër.

Mukades Gixhari . Po mbledhjen e radhës duhet ta kemi.

Mitat Daja . Koli dhe Isai folën, është tjetër gjë çfarë kanë kontrata dhe tjera kush ka bërë kontrata e di vetë jep përgjigje ai që ka bërë kontrata. Ne po flasim e vërteta është që Egnatia i ka dhënë një emër Rrogozhinës unë nuk e njoh fare Demrozin as nuk jam ulur ndonjëherë me të nuk



e kam idenë kush është ai. Nëse ai ka probleme tjetër kush i zgjidh problemet, ne po flasim për diçka që është bërë e vërteta është kjo, tani Koli ka hedhur një propozim dhe ky propozim e pakta se ju jeni bërë shumë gallatë ju të mëdhenjtë quheni, po ndoshta sdo jeni për shumë kohë të mëdhenj do bëheni dhe ju të vegjël flisni vetë ikni kur doni vetë.

Mukades Gixhari . Edhe një herë do ta përsërisësh këtë.

Mitat Daja . Ju të mëdhenjtë jeni bërë shumë gallatë.

Mukades Gixhari . Kush janë ju?

Isa Halili . Ato që klasifikohen që janë kryetar grupeve.

Mitat Daja . Ato që janë pretendojnë kryetarë nuk e di kryetarët e kujt janë. Ideja është që Koli dha një propozim e pakta ti zysh si menaxhere e këtij këshilli nëse ka debate të tjera ...

Edison Memolla . Është pjesë e komisionit...

Mitat DajaKa një kryetar bashkie që të japë përgjigje për kontrata ku e di unë ...

Mukades Gixhari . Është marrë propozimi.

Mitat Dajase çfarë ka bërë kryetari 25 % apo 10 % . E vërteta është ne jemi bashkëpronar. Edhe Koli tha diçka një person ka një problem ka një gjë ne duhet të vlerësojmë punën që bën një person, jetën private, aspektin ligjor të atij nuk është pjesë e imja. E vërteta është që ai ka bërë një punë shumë të mirë për Rrogozhinën. Rrogozhina nëse deri dje nuk është dëgjuar sot është dëgjuar, tani pse mos e mbështesim për inate personale, menaxhoje më mirë.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Mitat. Keni ndonjë diskutim tjetër?

Isa Halili . Ato për çështjen e këtyre të menaxhimit të tërmetit kam folur dhe Rezartin është po ajo gjë që ka thënë deri diku që janë disa emra që kanë përfituar ose meritojnë që duhen parë me një sy më kritik më të qartësuar.

Mukades Gixhari . Atëherë mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Ju faleminderit për kohën.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 17 : 30^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati rreth 03 orë ; 16 min ; 38 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 61 (gjashtë dhjetë e një).

Miratohet procesverbali :

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**